

# SHËRBIMI I FISKALIZIMIT

(VERSIONI V5)

SPECIFIKIMET FUNKSIONALE

## INFORMACIONI I PËRGJITHSHME PËR DOKUMENTIN

### Rishikimet e dokumentit

Versioni	Përshkrimi i Ndryshimit
v01	Versioni Fillestar
v02	Terminologjia e përdorur në Legjilacionin për termat dhe për kapitullin e shkurtimeve
v03	<ul style="list-style-type: none"><li>• Terminologjia e ndryshuar dhe e përditësuar</li><li>• Shpjegim i shtuar për regjistrimin e depozitës së parave në dorë</li><li>• Shpjegim i shtuar për procedurën e fiskalizimit të faturave korrigjuese</li><li>• Detaje të modifikuara në lidhje me aplikacionit e kodit QR</li><li>• Më shumë rregulla biznesi të shtuar</li><li>• Përshkrimi i shtuar për çregjistrimin e pajisjes elektronike të faturimit</li><li>• Mesazh i përditësuar për fiskalizimin e faturës</li><li>• Shpjegim i shtuar në lidhje me mesazhin e fiskalizimit të këmbimit të valutave</li><li>• Mesazh i përditësuar për fiskalizimin e faturave pa para në dorë</li><li>• Mesazhi i përditësuar i fiskalizimit të faturave korrigjuese</li><li>• Mesazhi i përditësuar i fiskalizimit për faturat shoqëruese</li><li>• Përditësohet lista e vlerave në lidhje me shërbimin fiskal</li><li>• Shpjegim i shtuar në lidhje me listën e gabimeve dhe përshkrimin e gabimeve për procedurën e verifikimit të "back-up".</li></ul>
v04	<ul style="list-style-type: none"><li>• Shtimi i faturës shoqëruese</li></ul>
v05	<ul style="list-style-type: none"><li>• Saktësime në faturën korrigjuese</li></ul>

## Përmbajtja

<b>1 TERMA DHE SHKURTIME.....</b>	<b>5</b>
<b>2. RRETH KËTIJ DOKUMENTI .....</b>	<b>5</b>
<b>3. TERMA TË PËRGJITHSHËM .....</b>	<b>6</b>
3.1 KODI I SIGURISË SË LËSHUESIT TË FATURËS (NSLF) .....	6
3.2 NUMRI I SIGURISË SË LËSHUESIT TË FATURËS SHOQËRUESE (NSLFSH).....	7
3.3 IDENTIFIKUESI UNIK I FATURËS (NIVF) .....	7
3.4 IDENTIFIKUESI UNIK I FATURËS SHOQËRUESE (NIVFSH).....	8
3.5 FISKALIZIMI .....	9
3.6 FATURA .....	9
<b>4. PJESËMARRËSIT .....</b>	<b>12</b>
<b>5. PROCESET E PUNËS .....</b>	<b>13</b>
5.1 AKTIVITETET PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË FISKALIZIMIT .....	15
5.2 REGJISTRIMI I PAJISJES ELEKTRONIKE TE FATURIMIT DHE I SOFTUERIT .....	16
5.3 REGJISTRIMI I GJENDJES SË PARAVE CASH NË ARKË .....	19
5.4 FISKALIZIMI I FATURAVE.....	22
5.4.1 FISKALIZIMI I FATURAVE PËR TRANSAKSIONE ME PARA NË DORË.....	23
5.4.2 FISKALIZIMI I FATURAVE PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË.....	28
<b>5.5 FISKALIZIMI I FATURAVE KORRIGJUESE/SAKTËSUESE .....</b>	<b>30</b>
5.6 FISKALIZIMI I FATURËS SHOQËRUESE .....	33
5.7 KRIJIMI DHE KONTROLI I KODIT QR.....	35
5.8 VERIFIKIMI I NSLF-SË NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË FATURIMIT .....	36
<b>6. RREGULLAT E PUNËS.....</b>	<b>37</b>
6.1 PROCESI I REGJISTRIMIT TË PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT DHE SOFTUERIN E FISKALIZIMIT PËR FATURAT ME TRANSAKSIONE ME PARA NË DORË .....	37
6.2 PROCESI I REGJISTRIMIT PËR SOFTUERIN E FISKALIZIMIT PËR FATURAT PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË DHE PËR FATURAT SHOQËRUESE .....	37
6.3 REGJISTRIMI I GJENDJES TË PARAVE CASH NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË FATURIMIT (ARKË)....	38
6.4 FISKALIZIMI I FATURAVE PËR TRANSAKSIONE ME PARA NË DORË/FATURAVE SHOQËRUESE ....	38
6.5 FISKALIZIMI E FATURAVE PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË .....	39
6.6 VALIDIMI I FATURAVE PARA SE TË RUHEN NË DATABAZËN E PLATFORMËS QENDRORE TË FATURËS .....	39
6.7 VALIDIMI I FATURAVE TË PRANUARA PASI JANË REGJISTRUAR NË DATABAZËN E PLATFORMËS QENDRORE TË FATURAVE .....	39
6.8 FATURAT KORRIGJUESE .....	39

<b>7. STRUKTURA E MESAZHEVE XML.....</b>	<b>41</b>
<b>7.1 STRUKTURA E MESAZHIT XML PËR REGJISTRIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT .....</b>	<b>41</b>
<b>7.2 STRUKTURA E MESAZHEVE XML PËR REGJISTRIMIN E GJENDJES FILLESTARE TË PARAVE CASH..</b>	<b>41</b>
<b>7.3 MESAZHI PËR FISKALIZIMIN E FATURËS .....</b>	<b>43</b>
7.3.1 MESAZHI PËR FISKALIZIMIN E FATURAVE PËR TRANSAKSIONET ME PARA NË DORË NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT.....	43
7.3.2 MESAZHI MBI FISKALIZIMIN E FATURAVE PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË .....	52
<b>7.4 MESAZHI PËR FISKALIZIMIN E FATURAVE KORRIGJUESE .....</b>	<b>55</b>
<b>7.5 MESAZHI PËR FISKALIZIMIN E FATURAVE SHOQËRUESE .....</b>	<b>56</b>
<b>8. LISTAT E VLERËS QË LIDHEN ME SHËRBIMIN E FISKALIZIMIT .....</b>	<b>60</b>
<b>9. KONTROLLI I MESAZHIT XML NGA ADMINISTRATA TATIMORE .....</b>	<b>62</b>
9.1 KONTROLLET PAS RUAJTJES SE MESAZHIT XML.....	63
9.2 KONTROLLE PAS RUAJTJES SË MESAZHIT XML NË DATABAZË.....	65
<b>10. LISTA E GABIMEVE .....</b>	<b>67</b>
10.1 PËRSHKRIMI I GABIMIT PËR PROCEDURËN E KONTROLLIT PAS RUAJTJES NË DATABAZË .....	67

## 1 TERMA DHE SHKURTIME

Shkurtimi	Shpjegimi	Terminologjia e përdorur në Dokumentacionin teknik
CIS	<b>Sistemi Qendror i Informacionit</b> - Sistemi i Informacionit të Administratës Tatimore për marrjen e të dhënave për faturat e lëshuara	Sistemi Qendror i Faturave
CIP	<b>Platforma Qendrore e Faturave</b> - portali që tatimpaguesi mund të përdorë për konfirmimimn e disa të dhënave dhe procedurave të tjera në lidhje me lëshimin e faturës dhe procesin e fiskalizimit	***Nuk përdoret në dokumenta teknike
UUID	<b>Identifikues Unik Universal</b> - Identifikues unik	<b>UUID - Identifikues Unik Universal</b>
ISC	<b>Kodi i Sigurisë së Lëshuesit të Faturës</b> - kodi i Sigurisë së lëshuesit të fatures(NSLF)	IIC – Kodi identifikues i faturës
UII	<b>Unique invoice identifier</b> – Kofi unik i faturës (NIVF)	FIC – Kodi i identifikimit fiskal
NIPT	<b>Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm</b> - numër unik i identifikimit të tatimpaguesit	NUIS - Numri Unik Identifikues Kombetar
CA	<b>Autoriteti i Certifikimit</b> - Enti përgjegjës për lëshimin dhe administrimin e certifikatave elektronike	AC- Autoriteti i Certifikimit
ECD	<b>Pajisja Elektronike e Faturimit</b> - pikë elektronike e pajisjes së shitjes (makinë me para në dorë) që ndonjëherë quhet një pajisje fiskale për lëshimin e faturave për transaksionet me para në dorë.Kjo pajisje lidhet me Shërbimin Fiskal Qendron në DPT	TCR- Arka e Tatimpaguesit
ECDC	<b>Kodi i Pajisjes Elektronike të Faturimit</b> - Kodi Unik i Arkës	***Nuk përdoret në dokumenta teknike
WTNISC	<b>Kodi i Identifikimit të Faturës Shoqëruese</b> (Numri i Sigurisë së Lëshuesit të Faturës shoqëruese NSLFSSH)	NSLFSH - Numri identifikues i faturës shoqëruese
UWTNI	<b>Kodi fiskal i Faturës Shoqëruese</b> (Numri identifikues i veçantë i faturës shoqëruese NIVFSH)	NIVFSH - Numri identifikues i veçantë i faturës shoqëruese
B2C	<b>Biznes te Klienti</b> - transaksionet mes tatimpaguesve dhe dhe klientit individual, që nuk është person i tatueshëm	B2C- Biznesi te Klienti
B2B	<b>Biznesi te Biznesi</b> - transaksionet mes dy tatimpaguesve	B2B- Biznesi te Biznesi
B2G	<b>Biznesi te Qeveria</b> - transaksion mes tatimpaguesve dhe organeve publike	B2G- Biznesi te Qeveria

Tabela 1 – Terma dhe shkurtime

## 2. RRETH KËTIJ DOKUMENTI

Ky dokument përshkruan mënyrën e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Sistemit Qendror të Informacionit të Administratës Tatimore dhe tatimpaguesve të Sistemit të Fiskalizimit. Dokumenti është në funksion të të gjithë palëve të interesuara që do të marrin pjesë në zbatimin e zgjidhjes në anën e tatimpaguesit. Dokumenti përshkruan të gjitha mesazhet që sistemet shkëmbejnë, proceset e shkëmbimit të mesazheve, grupet e përcaktuara të të dhënave dhe rregullat që respektohen rreptësisht në komunikim. Shkëmbimi i të dhënave do të bëhet përmes shërbimit në internet, duke përdorur mesazhe XML. Ky lloj shkëmbimi të të dhënave nuk varet nga teknologjia e përdorur nga tatimpaguesit ose nga teknologjia e përdorur nga Administrata Tatimore dhe lejon komunikim të njëtrajtshëm midis çdo tatimpaguesi dhe Administratës Tatimore.

### 3. TERMA TË PËRGJITHSHËM

#### 3.1 KODI I SIGURISË SË LËSHUESIT TË FATURËS (NSLF)

NSLF e tatimpaguesit është një kod alfanumerik që konfirmon lidhjen midis tatimpaguesit që ka detyrim të lëshojë fatura dhe faturës së lëshuar.

Kodi NSLF është krijuar nga zgjidhja softuerike që përdoret për lëshimin e faturave dhe është një element detyrues për secilën faturë të lëshuar dhe kjo do të konfirmohet në Administratën Tatimore bashkë me elementët e tjerë detyrues të faturës.

Qëllimet e NSLF janë:

- a) mbrojtje e tatimpaguesit nga përpjekjet e mundshme për të shkaktuar dëme nga një palë e tretë. Vetëm i njëjti tatimpagues mund të krijojë të njëjtin NSLF, bazuar në parametrat hyrës për ndërtimin e kodit (procedura se si gjenerohet kodi është përshkruar në specifikimet teknike të shërbimit të fiskalizimit).
- b) verifikim i faturës në rastet kur fatura është lëshuar pa NIVF. Në këtë rast, NSLF mund të përdoret si një identifikues i faturës.

Në mënyrë që të sigurohen masat e lartpërmendura, NSLF duhet të përcaktohet me disa parametra sigurie, siç thuhet më poshtë:

I. Unicitetin e faturës, me verifikimet e mëposhtme:

- NIPT i tatimpaguesit,
- data dhe ora e lëshimit të faturës,
- numri i faturës,
- kodi i vendndodhjes së ushtrimit të aktivitetit të biznesit,
- kodi i ECD (pajisjes elektronike të faturimit) për pagesat me para në dorë,
- kodi i softuerit të përdorur,
- shuma totale e faturës

II. Vërtetësia e përdoruesit me verifikimet e mëposhtme:

- nënshkrimi elektronik i tatimpaguesit

Detajet se si NSLF është përcaktuar shpjegohet në specifikimet teknike të shërbimit të fiskalizimit.

Nënshkrimi elektronik bëhet duke përdorur certifikatën elektronike të vlefshme nga AKSHI, për shërbimin e fiskalizimit të tatimpaguesit.

Nëse një faturë lëshohet përmes Platformës Qendrore të Faturave, atëherë NSLF nuk ka kodin e ECD-së (arke) të tatimpaguesit ose kodin e softuerit, dhe ajo gjenerohet nga Shërbimi Web i Administratës Tatimore.

### 3.2 NUMRI I SIGURISË SË LËSHUESIT TË FATURËS SHOQËRUESE (NSLFSH)

Kodi NSLFSH i tatimpaguesit është një kod alfanumerik që konfirmon lidhjen midis tatimpaguesit që ka lëshuar faturën shoqëruese dhe faturës shoqëruese të lëshuar. NIVFSH gjenerohet nga tatimpaguesi, p.sh. zgjidhja softuerike që ai përdor për lëshimin e faturave shoqëruese dhe kjo duhet dërguar tek Administrata Tatimore në kohë reale së bashku elementët e tjerë të detyrueshëm të faturës shoqëruese.

Qëllimet e kodit NSLFSH janë të njëjta si në pjesën paraprake për NSLF. Për të siguruar këto qëllime, kodi NSLFSH duhet të përcaktohet me disa parametra që sigurojnë:

I. Unicitetin e faturës shoqëruese. Verifikimet që do të kryhen:

- NIPT-i i tatimpaguesit
- data dhe ora e lëshimit të faturës shoqëruese
- numri i faturës shoqëruese
- kodi i vendndodhjes së ushtrimit të aktivitetit të biznesit
- kodi i zgjidhjes softuerike

III. autenticitetin e përdoruesit. Verifikimet që do të kryhen:

- nënshkrimi elektronik i tatimpaguesit

Nënshkrimi elektronik bëhet duke përdorur certifikatën elektronike të vlefshme AKSHI për fiskalizimin që i është dhënë tatimpaguesit.

Algoritmi i llogaritjes së kodit NSLFSH mund të përmbledhet si më poshtë: hash MD5 (nënshkrimi i çelësit privat (NIPT + data dhe ora e lëshimit) + numri i faturës shoqëruese + kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit + kodi i softuerit)).

### 3.3 IDENTIFIKUESI UNIK I FATURËS (NIVF)

Si shkurtim për kodin e identifikuesit të faturës përdoret “NIVF”.

Tatimpaguesi, kur lëshon secilën faturë, nënshkruan në mënyrë elektronike elementet e faturës dhe i dërgon ato në sistemin e fiskalizimit përmes lidhjes elektronike të vendosur.

Sistemi i fiskalizimit verifikon nëse janë dërguar të gjithë elementët e kërkuar të faturës dhe nëse ato janë nënshkruar me nënshkrimin e saktë elektronik, duke përdorur një certifikatë të vlefshme elektronike.

Nëse përmbushen të gjitha kushtet, shërbimi i fiskalizimit gjeneron një kod unik NIVF dhe ia kthen atë tatimpaguesit përmes lidhjes elektronike të krijuar. Sistemi i fiskalizimit jep kodin NIVF si një konfirmim i elementeve të marra të faturës. Kodi NIVF është unik për çdo faturë.

Nëse Sistemi i Fiskalizimit i Administratës Tatimore nuk mund të përcaktojë kodin NIVF, sepse nuk është kryer procesi i kontrollit (vlerësimit), ai i kthehet tatimpaguesit me një mesazh refuzimi të gjenerimit të kodit NIVF, përmes lidhjes së internetit, së bashku me përshkrimin e gabimit. Tatimpaguesi në këto raste, siç është specifikuar në Nr. 16, datë 03.04.2020 “Për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit”, të printojë

faturën pa NIVF dhe ia dorëzon atë blerësit, rregullon gabimin e llogaritur dhe përsërit processin e fiskalizimit brenda 48 orëve të së njëjtës faturë, me të njëjtën NSLF. Në situata të veçanta të specifikuar në Udhëzuesin Nr. 16, datë 03.04.2020 "Për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit", tatimpaguesi ka korrigjuar se pari gabimin, pas kësaj ka përsëritur procesin e fiskalizimit dhe vetëm pas verifikimit të suksesshëm printon faturën dhe ia dorëzon atë blerësit.

NIVF dhe NSLF, bashkë me të dhënat e tjera të detyrueshme, printohen në faturën për transaksione me para në dorë dhe ato janë elementë të detyrueshëm të secilës faturë elektronike në transaksionet pa para në dorë.

### 3.4 IDENTIFIKUESI UNIK I FATURËS SHOQËRUESE (NIVFSH)

Si shkurtim për Identifikuesin Unik për faturën shoqëruese përdoret kodi NIVFSH.

Tatimpaguesi, kur lëshon secilën faturë shoqëruese, nënshkruan në mënyrë elektronike elementet e faturës shoqëruese dhe ia dërgon ato sistemit të fiskalizimit përmes lidhjes elektronike të vendosur. Sistemi i fiskalizimit kontrollon nëse të gjithë elementët e përshkruar të faturës shoqëruese janë dërguar dhe nëse ato janë nënshkruar nga nënshkrimi i saktë elektronik duke përdorur një certifikatë të vlefshme elektronike. Nëse përmbushen të gjitha kushtet e mësipërme, sistemi i fiskalizimit të Administratës Tatimore gjeneron kodin NIVFSH dhe ia dërgon atë tatimpaguesit me anë të lidhjes elektronike të vendosur. Sistemi i fiskalizimit dërgon kodin NIVFSH si një konfirmim i pranimit të elementeve të faturës shoqëruese të lëshuar dhe verifikimit të parë të suksesshëm.

NIVFSH është unik për secilën faturë shoqëruese.

Nëse Sistemi i Fiskalizimit nuk gjeneron NIVFSH, për shkak se nuk janë arritur kontrole të suksesshme ose për arsye të tjera, tatimpaguesit i kthehet një mesazh refuzues për gjenerimin e NIVFSH me anë të lidhjes elektronike të vendosur me përshkrimin e gabimit. Tatimpagues mund të printojë kodin QR të asaj fature shoqëruese, por duhet të korrigjojë gabimin e hasur dhe të përsërisë procesin e fiskalizimit brenda 48 orësh.

NIVFSH dhe NSLFSH, bashkë me të dhënat e detyrueshme, janë elementet e detyrueshme për secilën faturë shoqëruese kur transportohen mallrat nga një magazinë në tjetrën, ose në një dyqan të tatimpaguesit, pa ndryshim të pronësisë së mallrave. Në sektorë të veçantë të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për lëshimin e dokumentave dhe procedurat e Fiskalizimit për monitorimin e qarkullimit dhe transportimit të mallrave", fatura shoqëruese me NIVFSH dhe NSLFSH së bashku me elementet e detyrueshme duhet të lëshohen për transportimin e mallrave nga shitësi tek blerësi, bashkë me faturën.



### 3.5 FISKALIZIMI

Fiskalizimi është një procedurë e krijuar për të shmangur mashtrimin dhe është prezantuar në shumë vende të ndryshme për kontrollimin e ekonomisë gri duke bërë të detyrueshëm raportimin në kohë reale e të gjitha transaksioneve ose transaksione specifike tek autoritetet tatimore.

### 3.6 FATURA

Sistemi i fiskalizimit trajton dy lloje të faturave:

- a. Faturat në transaksionet e pagesave me para në dorë
- b. Faturat në transaksionet e pagesave pa para në dorë

Në lidhje me elementët e detyrueshëm të faturës, ne i dallojmë faturat e mëposhtme sipas Ligjit “Për faturën dhe sistemin për monitorimin e transaksioneve” dhe Ligjit të TVSH-së:

- a) faturë pa TVSH
- b) faturë me TVSH
- c) faturë e thjeshtë me TVSH dhe faturë e thjeshtë pa TVSH
- d) faturë elektronike

Po ashtu, në lidhje me momentin e lëshimit të faturës ajo mund të lëshohet për qëllime specifike faturë periodike dhe faturë përmbledhëse, me të njëjtat elementë të faturës siç përcaktohen për faturat e lartpërmendura, me elementët shtesë: për faturën periodike është e detyrueshme të vendoset në faturë periudha e së cilës i referohet kjo faturë, dhe nuk mund të jetë më shumë se një muaj; dhe për faturën përmbledhëse është e detyrueshme të vendoset në faturë numri i kartës së përdorur si metodë pagese për faturat individuale të lëshuara në të njëjtin muaj, për të cilin kjo përmbledhëse ose kjo faturë përmbledhëse është lëshuar dhe NSLF e secilës faturë individuale është përfshirë në faturën përmbledhëse.

Tatimpaguesi dërgon informacionin e faturës tek Admimintarta Tatimore individualisht për secilën faturë të lëshuar për transaksione me para në dorë dhe transaksionet pa para në dorë në momentin e lëshimit. Në raste të veçanta, të dhënat e faturës mund të dërgohen më vonë, por vetëm në situata specifike të përcaktuara nga Ligji.

Në të dy rastet (transaksionet e pagesave me para në dorë dhe pa para në dorë), procesi i dërgimit të të dhënave është identik në lidhje me komunikimin me Platformën Qendrore të Faturave(CIS), i vetmi ndryshim është në përmbajtjen e mesazhit.

Procesi i shkëmbimit të të dhënave fillon kur operatori në pajisjen fiskale (ECD (arkë)-ose në pajisjen elektronike të faturimit) duhet të lëshojë një faturë klientit:

- a) Pajisje elektrike e faturimit (arka) ose çdo pajisje elektronike e një tatimpaguesi me zgjidhje softuerike të instaluar për lëshimin e faturave, pasi operatori plotëson të gjithë elementët e faturës, përgatit të dhënat për faturën dhe në bazë të tyre llogarit kodin e sigurisë të lëshuesit të faturës (NSLF) në përputhje me

algoritmin e përshkruar në kapitullin " I SIGURISË I LËSHUESIT TË FATURËS KODI I I SIGURISË I LËSHUESIT TË FATURËS (NSLF)".

- b) Pas kësaj, përgatit kërkesën e mesazhit XML dhe e nënshkruan në mënyrë elektronike me çelësin privat të certifikatës elektronike së aplikimit të lëshuar për tatimpaguesin, për qëllime të fiskalizimit nga AKSHI. Pastaj fillohet komunikimi, dhe serveri i Administratës Tatimore identifikohet me certifikatën e serverit.
- c) Pas një komunikimi të suksesshëm SSL, realizohet dërgimi i kërkesës. Platforma Qendrore e Faturave merr dhe përpunon mesazhin e kërkesës. Nëse kërkesa përpunohet me sukses nga Shërbimi i Fiskalizimit, bëhet gati mesazhi i përgjigjes XML që përmban NIVF, nënshkruhet në mënyrë elektronike me çelësin privat të certifikatës së aplikacionit dhe dërgohet tek ECD-ja (pajisja elektronike e faturimit), i cila merr një mesazh përgjigjeje dhe kontrollon nënshkrimin elektronik me çelësin publik të certifikatës së aplikacionit. Pas kësaj, operatori printon ose dërgon në mënyrë elektronike një faturë tek blerësi, d.m.th. duke deklaruar NIVF.

Nëse gjatë përpunimit të mesazhit të faturës ka ndodhur një gabim (mesazhi i pasaktë nga skema XML, nënshkrimi elektronik i dëmtuar, etj.), Shërbimi i Fiskalizimit kthen mesazhin e përgjigjes XML që përmban përshkrimin e gabimit. Në këtë rast, përgjigja nuk përfshin NIVF dhe tatimpaguesi, pra operatori, është i detyruar të korrigjojë gabimin dhe të ridërgojë faturën për fiskalizim, ose në rast se gabimi nuk mund të korrigjohet menjëherë, ( kur një gabim i sistemit ndodh gjatë përpunimit të kërkesës ose ka një gabim teknik ose gabimi është i lidhur me certifikatën elektronike), ai është i detyruar të lëshojë faturën pa NIVF dhe të korrigjojë gabimin (vetë ose prodhuesi/ mirëmbajtësi i softuerit) brenda 48-orësh dhe fiskalizon të njëjtën faturë më pas. Kjo faturë që është dërguar në procedurën e fiskalizimit dhe e printuara dhe që është dhënë klientit më pas nuk duhet të ndryshohet nga operatori, vetëm një mesazh i ri XML duhet të krijohet bazuar në faturën e lëshuar. Procesi i punës për lëshimin e një fature nuk duhet të ndalet për shkak të gabimit të sistemit ose gabimit teknik, por tatimpaguesit i kërkohet të korrigjojë parregullsitë e hasura dhe mesazhi i faturës duhet të dorëzohet më pas. Mesazhi i përsëritur XML duhet të jetë i njëjtë me një shënim (shenjë) shtesë që identifikon se është një paraqitje e përsëritur. Nëse ky shënim mungon ose NSLF është e ndryshme nga NSLF e printuar në faturën e lëshuar, ajo do të regjistrohet si një proces krejtësisht i ndryshëm i lëshimit të faturës.

### **E rëndësishme për t'u mbajtur mend!**

Nëse ndodh një nga gabimet e mëposhtme gjatë përpunimit të mesazhit të fiskalizimit të kërkesës:

1. mesazhi i marrë XML tejkalon madhësinë e lejuar,
2. mesazhi i marre XML i validimit të dështuar XSD (sepse disa fusha të detyrueshme mungojnë),
3. shuma e faturës tepër e madhe për tu paguar me para në dorë,
4. statusi i TVSH-së së lëshuesit nuk korrespondon me atributin `IsIssuerInVAT`, pastaj operatori që ka krijuar faturën duhet të kontrollojë nëse:
  1. ka më shumë se 1000 artikuj në faturë,
  2. nuk janë plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme,
  3. shuma që deklarohet në faturë është më shumë se 150.000 lekë, dhe mënyra e pagesës është me para në dorë (kartëmonedha dhe monedha),
  4. lëshuesi i faturës (pra. shitësi) është i regjistruar në regjistrin e TVSH-së dhe atributi `IsIssuerInVAT` është "false", dhe anasjelltas (në këtë rast nëse tatimpaguesi nuk është i regjistruar në regjistrin e TVSH-së dhe nuk është rast i "auto-ngarkesës" që TVSH-ja nuk mund të ngarkohet në atë faturë).

Në çdo rast, operatori nuk mund të lëshojë një faturë të tillë (zgjidhja e softuerit nuk mund të ketë funksionin që operatori mund të printojë një faturë të tillë), pasi vetë fatura nuk është e saktë dhe duhet të:

1. ndahet fatura në 2 ose më shumë fatura të reja në mënyrë që në secilën faturë të mos ketë më shumë se 1.000 artikuj;
2. plotësohen fushat ku mungojnë elementët e detyrueshëm të faturës (d.m.th. fushat në mesazhin e fiskalizimit);
3. ndryshohet mënyra e pagesës nëse shuma është më shumë se 150.000 lekë (nuk mund të jenë kartëmonedha dhe monedha);
4. korrigjohet atributi `IsIssuerInVAT` sipas statusit të shitësit të regjistruar në regjistrin e Administratës Tatimore të tatimpaguesve dhe TVSH-në në faturë në përputhje me rrethanat.

**Sidoqoftë, prodhuesi i softuerit duhet të parandalojë gabime të tilla, duke integruar kontrole automatike në momentin kur fatura po krijohet nga operatori dhe përpara se të lëshohet dhe dërgohet për fiskalizim.**

Në të gjitha rastet kur për ndonjë arsye tatimpaguesi nuk mund të marrë një NIVF për faturën e lëshuar (ndërprerja e lidhjes në Internet, mosfunksionimi i pajisjes elektronike të faturimit, gabim në mesazhin e përgjigjes, mosfunksionimi i përkohshëm i Platformës Qendrore të Faturave), ai duhet të dërgojë përsëri mesazhin. Vetëm kur tatimpaguesi merr përgjigje me një mesazh të saktë nga Sistemi i Fiskalizimit të Administratës Tatimore që përmban NIVF, mund të konsiderohet se fatura është raportuar në Administratën Tatimore.

Në rastet kur një tatimpaguesi nuk mund të marrë një NIVF, p.sh. ndërprerja e lidhjes në internet dhe lidhja është rivendosur, dërgimi i të gjitha faturave të lëshuara në mënyrën offline (pa internet) duhet të kryhet automatikisht. Në rastet kur një tatimpaguesi nuk mund të marrë një NIVF për shkak të një gabimi të hasur gjatë procedurës së verifikimit, pas korrigjimit të gabimit në lidhje me procesin e fiskalizimit për faturat për transaksionet me para në dorë, përparësi u jepet mesazheve që raportojnë fatura të reja, në mënyrë që ata të marrin NIVF dhe mund të lëshohen menjëherë, pa vonesë për

klientin. Mesazhet që nuk kanë marrë NIVF duhet të dorëzohen më vonë në periudhën e trafikut më të vogël të pajisjes elektronike e faturimit.

Koha maksimale (time-out) që tatimpaguesit i duhet të presë një mesazh përgjigjeje me NIVF nga Sistemi i Fiskalizimit të Administratës Tatimore, përcaktohet nga tatimpaguesi. Tatimpaguesi duhet të bëjë një vlerësim të kohës duke marrë parasysh llojin dhe disponueshmërinë e lidhjes në internet që ai përdor dhe kohën e përshtatshme për biznesin për të marrë përgjigje. Gjatë vlerësimit, duhet të merret në konsideratë një kohë maksimale prej 2 sekondash, në të cilën Platforma Qendrore e Faturave (CIS) duhet të përpunojë mesazhin e kërkesës dhe të kthejë mesazhin e përgjigjes (koha nga momenti kur mesazhi i kërkesës hyn në Platformën Qendrore të Faturave në mesazhin e përgjigjes nga Platforma Qendrore e Faturave).

#### 4. PJESËMARRËSIT

Pjesëmarrësit (Aktorët) në procesin e fiskalizimit janë:

**Tatimpaguesit** - të gjithë tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturat dhe faturat shoqëruese - janë të detyruar të lëshojnë fatura dhe fatura shoqëruese në përputhje me Ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të transaksione, Vendimi i Këshillit të Ministave dhe Udhëzimin Nr. 16, datë 03.04.2020 "Për faturën dhe monitorimin e sistemit të qarkullimit " dhe të kryejnë procesin e fiskalizimit për të gjitha faturat dhe faturat shoqëruese.

**Operatori** - personi i autorizuar nga tatimpaguesi për lëshimin e faturave dhe faturave shoqëruese (në shumicën e rasteve është punonjës i tatimpaguesit) dhe i cili punon në një pajisje elektronike e faturimit (arkë) gjatë procesit të fiskalizimit të një fature, ose personi që krijon një faturë për transaksione pa para në dorë ose që krijon një faturë shoqëruese. Në rastet e shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatet), operatori konsiderohet tatimpaguesi që lëshon faturën.

**Personi ose kompania prodhuese / mirëmbajtësi i softuerit** - Përgjegjës për pajtueshmërinë e Zgjidhjes Softuerike IT me procesin e fiskalizimit. Personi/kompania është ofrues i shërbimit ndaj tatimpaguesit.


**AKSHI** - përgjegjës për administrimin e Platformës Qendrore të Faturave për shërbimin e fiskalizimit, Ofruesi i Shërbimit të Administratës Tatimore.

**Administrata Tatimore** - përgjegjëse për zbatimin e procesit të fiskalizimit dhe mbikëqyrjen e fiskalizimit të faturave dhe faturave shoqëruese.

**Qytetarët** - përdoruesit e sistemit për kontrollimin e korrektësisë së faturës, duhet të kërkojnë faturën për mallrat ose shërbimet e blera dhe të kenë mundësinë të raportojnë parregullsitë e evidentuara në Administratën Tatimore.

## 5. PROCESET E PUNËS

Ky kapitull përshkruan proceset kyçe të punës të lidhura me shërbimin e fiskalizimit, të gjithë skenarët që duhen mbështetur në shërbimin e fiskalizimit për transaksionet me para në dorë dhe pa para në dorë (përveç faturës elektronike, e cila do të përshkruhet në dokumenta të veçantë) dhe për fiskalizimin e faturës shoqëruese.



**Diagram 1-Proçesi i fiskalizimit**

Nën-proceset e punës që lidhen me shërbimin e fiskalizimit janë:

1. Aktivitetet përgatitore për përdorimin e shërbimit të fiskalizimit

2. Regjistrimi i pajisjes elektronike e faturimit dhe softuerit
3. Regjistrimi i gjendjes së parave cash të pajisjes elektronike të faturimit
4. Fiskalizimi i faturave
5. Fiskalizimi i faturave korrigjuese
6. Fiskalizimi i faturave shoqëruese
7. Printimi dhe kontrolli i kodit QR në faturë
8. Verifikimi i NSLF në pajisjen elektronike e faturimit

## 5.1 AKTIVITETET PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË FISKALIZIMIT

Parakushtet për implementimin e faturës dhe fiskalizimin e faturës dhe faturës shoqëruese janë si më poshtë:

1. Zotërimi i një certifikate elektronike (më shumë detaje mund të gjenden në dokumentin e specifikimeve teknike të shërbimit të fiskalizimit).
2. Zotërimi i një lidhjeje interneti (përveç në raste të veçanta siç përshkruhet në Ligj).

Të gjitha aktivitetet e përgatitjes të përshkruara në këtë kapitull, zhvillohen në vendin e tatimpaguesit dhe përgjegjësia për këto veprime përgatitore i takon tatimpaguesit.

Një certifikatë elektronike për qëllime të fiskalizimit lëshohet nga autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatave elektronike (CA). Në rastin e Republikës së Shqipërisë është AKSHI. Një përshkrim i detajuar i paraqitjes së një kërkesë për lëshimin e një certifikate elektronike dhe marrjen e saj është përcaktuar në udhëzimet e AKSHI dhe nuk është subjekt i këtij dokumentacioni.

Para instalimit të një certifikate elektronike, tatimpaguesi është i detyruar:

**Hapi 1** - Në rastin e fiskalizimit të faturës dhe faturës shoqëruese, tatimpaguesi është i detyruar:

- a. të ketë një infrastrukturë harduerike me softuerin që mbështet procesin e fiskalizimit, ose që mund të aksesojë CIP (Platformën Qendrore të Faturave) (vetëm tatimpaguesit e veçantë të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave).
- b. të ketë një lidhje të përhershme në internet që është e nevojshme për punën e shërbimit të fiskalizimit

**Hapi 2a.** - Në rastin e fiskalizimit të faturës për pagesa me para në dorë, tatimpaguesi duhet:

- a. të instalojë softuer në pajisjen elektronike të faturimit për lëshimin e një fature që mbështet procesin e fiskalizimit në secilën pajisjen elektronike e faturimit që do të ekzekutojë procesin e fiskalizimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.
- b. të instalojë një certifikatë elektronike të shkarkueshme në secilën pajisje elektronike të faturimit që do të kryejë procesin e fiskalizimit të faturave dhe ku softueri për lëshimin e faturave është instaluar.

**Hapi 2b.** - Në rastin e fiskalizimit të faturave për pagesa pa para në dorë, tatimpaguesi duhet të:

- a. Implementojë / përditësojë softuerin ekzistues për lëshimin e faturave për transaksione pa para në dorë në mënyrë të tillë që programi të mbështesë


procesin e fiskalizimit ose të përdorë aplikacionin në internet (cloud) me zgjidhje të përshtatshme softuerike për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave

b. të instalojë një certifikatë elektronike të shkarkueshme dhe ta lidhë atë me një program për lëshimin e faturave për transaksione pa para në dorë.

**Hapi 2c.-** Në rast të fiskalizimit të faturës shoqëruese, tatimpaguesi është i detyruar:

a. të instalojë softuer në pajisjen elektronike që përdoret për lëshimin e faturës shoqëruese dhe që mbështet procesin e shërbimit të fiskalizimit të Platformës Qendrore të Faturave, në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ku ruhen mallrat dhe ku fillon dërgesa.

b. të instalojë certifikatën elektronike të shkarkuar më parë në pajisjen elektronike, që do të kryejë procesin e fiskalizimit dhe që përmban softuer për lëshimin e faturës shoqëruese.



**Diagram 2 – Aktivitete përgatitore për përdorimin e shërbimit të fiskalizimit**

Në rastin e kompanisë së shitjeve me pakicë të hidrokarbureve, kur shitja dhe transferimi i produkteve të naftës tek tatimpaguesit e tjerë ose organet publike, në situatën kur duhet të lëshohet një faturë elektronike, sipas Neneve 24 dhe 25 të Ligjit “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”, tatimpaguesit (shitësi) mund të ketë në pikën e shitjes vetëm një pajisje elektronike dhe një zgjidhje softuerike, por që është e pajisur me dy shërbime të fiskalizimit: njëra për fiskalizimin e faturave për transaksione me para në dorë dhe tjetra për fiskalizimin e faturave shoqëruese në rast të transaksioneve pa para në dorë B2B dhe B2G.

## 5.2 REGJISTRIMI I PAJISJES ELEKTRONIKE TE FATURIMIT DHE I SOFTUERIT

Një tatimpagues është i detyruar të kryejë regjistrimin e një Pike të Shitjes / Pajisje Elektronike të Faturimit përpara fillimit të lëshimit dhe fiskalizimit të faturave, për të



gjitha pajisjet elektronike të faturimit që do të lëshojnë dhe do të fiskalizojnë faturat për transaksione me para në dorë.

Duke regjistruar pajisjen elektronike të faturimit në Platformën Qendrore të Faturave (CIS), ai gjithashtu do të regjistrojë prodhuesin e softuerit dhe zgjidhjes softuerike të përdorur në pajisjen elektronike të tatimpaguesit për të kryer procesin e fiskalizimit.

Në rastin e fiskalizimit të faturës për transaksionet pa para në dorë, pajisja elektronike e përdorur për të krijuar dhe lëshuar një faturë nuk duhet të regjistrohet. E njëjta vlen edhe për pajisjen elektronike për lëshimin e faturave shoqëruese.

Pasi tatimpaguesi ka kryer veprimet përgatitore, atij i kërkohet të përgatisë një mesazh fillestar për regjistrimin e secilës pajisje elektronike të faturimit. Gjatë përgatitjes së mesazhit fillestar XML për regjistrimin e pajisjes elektronike të faturimit, tatimpaguesi duhet të dërgojë të dhënat e mëposhtme:

1. Numri unik i identifikimit të tatimpaguesit (NIPT)
2. Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së Biznesit *(më shumë detaje mund të gjenden në dokumentin e specifikimeve teknike të shërbimit të fiskalizimit)*
3. Numri vijues i pajisjes elektronike të faturimit *(përcaktuar nga vetë tatimpaguesi, duke filluar nga 1)*
4. Kodi i softuerit i përdorur në pajisjen elektronike të faturimit *(më shumë detaje mund të gjenden në dokumentin e specifikimeve teknike të shërbimit të fiskalizimit)*
5. Kodi i mirëmbajtësit të softuerit të përdorur në pajisjen elektronike të faturimit
6. Data kur pajisja elektronike e faturimit do të jetë në përdorim
7. Lloji i ECD(pajisjes elektronike të faturimit)
  - normale
  - pajisje vetë-shërbimi (automat)

Pasi tatimpaguesi hyn në informacionin e specifikuar më lart, softueri i pajisjes elektronike të faturimit gjeneron një mesazh fillestar XML të regjistrimit, që përmban gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

- a. Data dhe ora e krijimit të mesazhit XML
- b. Data dhe ora e dërgimit të mesazhit XML tek Administrata Tatimore.

Pas gjenerimit të mesazhit XML, mesazhi nënshkruhet me nënshkrimin elektronik dhe i dërgohet Administratës Tatimore duke përdorur shërbimin e fiskalizimit.

Në raste të veçanta, nëse tatimpaguesi operon në një zonë ku nuk ka lidhje interneti, tatimpaguesi mund të regjistrojë pajisjen elektronike të faturimit në Platformën Qendrore të Faturave ose të plotësojë një formular në letër, sipas specifikimeve në Udhëzimin Nr. 16, datë 03.04.2020 “Për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit”, dhe të dërgojë atë fizikisht në zyrën lokale të Administratës Tatimore.

Pasi Administrata Tatimore të marrë mesazhin fillestar të regjistrimit, mesazhi i marrë verifikohet nga rregullat e mëposhtme:

1. pozicioni i certifikatës,
2. nëse certifikata e tatimpaguesit është lëshuar nga AKSHI,
3. vlefshmëria e certifikatës elektronike,
4. vlefshmëria e skemës së mesazhit,
5. nëse elementët e detyrueshëm të skemës janë plotësuar,
6. krahasohet NIPT nga mesazhi XML me NIPT-in e certifikatës,
7. krahasohet NIPT nga mesazhi XML me NIPT-in e tatimpaguesit nga regjistri i tatimpaguesëve,
8. krahasohet kodi i vendit të ushtrimit të aktivitetit të biznesit nga mesazhi XML me kodin e vendit të ushtrimit të aktivitetit të biznesit i regjistruar në Administratën Tatimore,
9. krahasohet kodi i softuerit nga mesazhi XML me kodin e softuerit nga baza e të dhënave të softuerëve të regjistruar dhe të certifikuar,
10. krahasohet kodi i prodhuesit të softuerit nga mesazhi XML me kodin e prodhuesit të softuerit nga baza e të dhënave të prodhuesve të softuerëve në regjistrin e AKSHI-it.

Nëse verifikimi i regjistrimit fillestar të mesazhit XML nuk e ka kaluar verifikimin, Administrata Tatimore gjeneron një mesazh XML me përshkrimin e gabimit dhe e dërgon atë në pajisjen elektronike të faturimit me shënimin që regjistrimi i pajisjes elektronike të faturimit ka dështuar.


Nëse verifikimi i regjistrimit fillestar të mesazhit XML është kryer nga Administrata Tatimore, sistemi i fiskalizimit i Administratës Tatimore:

1. Krijon një rekord për pajisjen elektronike të faturimit dhe e ruan atë në bazën e tij të të dhënave që lidhet me vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit,
2. Gjeneron një kod unik alfanumerik për pajisjen elektronike të faturimit
3. Vendos të dhëna të tjera që lidhen me pajisjen elektronike të faturimit në bazën e të dhënave.

Pas gjenerimit të rekordeve në bazën e të dhënave, Administrata Tatimore krijon një mesazh XML që përmban kodin alfanumerik unik për pajisjen elektronike të faturimit që përbëhet nga 10 karaktere (*hollësitë mund të gjenden në dokumentacionin teknik*). Kodi unik alfanumerik për pajisjen elektronike të faturimit është një kod i papërsëritshëm dhe unik i pajisjes elektronike të faturimit, që gjenerohet automatikisht nga sistemi dhe duhet të ruhet në memorjen e pajisjes elektronike të faturimit dhe në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore.

Pasi të jetë krijuar mesazhi XML, Administrata Tatimore nënshkruan mesazhin XML me një nënshkrim elektronik dhe ia dërgon tatimpaguesit duke përdorur shërbimin e fiskalizimit. Në raste të veçanta kur regjistrimi është bërë nga Platforma Qendrore e Faturave ose në formatin e duhur tatimpaguesi që ka bërë lëshimin e faturës është i detyruar ta vendosë atë manualisht dhe ta ruajë atë në memorjen e pajisjes elektronike të faturimit, pasi këto janë të dhëna të detyrueshme për fiskalizimin e faturave për pagesa me para në dorë.

Ndryshimet ose çregjistrimi i Pajisjes Elektronike të Faturimit bëhet duke përdorur të njëjtin shërbim fiskalizimi në vetë Pajisjen Elektronike të Faturimit. Në rast të çregjistrimit, fusha "e vlefshme deri" duhet të ketë datën në të cilën ajo pajisje elektronike e faturimit nuk do të përdoret më.



**Diagrama 3 – Regjistrimi i Pajisjes Elektronike të Faturimit dhe i Softuerit**

### 5.3 REGJISTRIMI I GJENDJES SË PARAVE CASH NË ARKË

Një tatimpaguesi që lëshon fatura, i kërkohet të njoftojë Administratën Tatimore në fillim të ditës së punës, pra para fillimit të punës dhe të lëshimit të faturës, për gjendjen fillestare të parave cash në çdo pajisje elektronike të faturimit (arkë) për atë ditë pune.

Një tatimpagues është gjithashtu i detyruar të raportojë çdo ndryshim në gjendjen e parave cash gjatë ditës të shkaktuara nga shtimi ose tërheqja e parave nga arka, pra nga pajisja elektronike e faturimit.

Pasi pajisja elektronike e faturimit është operacionale, tatimpaguesi është i detyruar të ekzekutojë funksionin "regjistrim i gjendjes së parave cash në pajisjen elektronike të faturimit". Çdo pajisje elektronike e faturimit duhet të ketë këtë funksionalitet. Sapo të ekzekutohet ky funksion, tatimpaguesi do të vendosë shumën e gjendjes fillestare së parave cash në pajisjen elektronike të faturimit në monedhën vendase. Pajisja elektronike e faturimit gjeneron një mesazh XML, të nënshkruar me certifikatën elektronike dhe e dërgon atë në Platformën Qendrore të Faturave duke përdorur shërbimit të fiskalizimit. Mesazhi duhet të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar që përcaktohet në skemën XML.

Platforma Qendrore e Faturave merr një mesazh të nënshkruar XML dhe kontrollon nënshkrimin elektronik dhe strukturën e mesazhit XML.

Nëse mesazhi **është i vlefshëm**, mesazhi ruhet në bazën e të dhënave, shërbimi i fiskalizimit krijon një përgjigje, që nënshkruhet me certifikatën elektronike të Administratës Tatimore dhe përgjigja i dërgohet pajisjes elektronike të faturimit së tatimpaguesit. Pasi pajisja elektronike e faturimit të marrë përgjigjen e Administratës Tatimore, tatimpaguesi mund të fillojë procesin e lëshimit të faturave dhe fiskalizimit të tyre.

Nëse mesazhi **nuk është i vlefshëm** në Platformën Qendrore të Faturave, shërbimi i fiskalizimit gjeneron një përgjigje XML me gabimin përkatës, i cili i dërgohet pajisjes elektronike të faturimit së tatimpaguesit. Tatimpaguesi është i detyruar që menjëherë të zgjidhë gabimin në sistemin e tij pas marrjes së përgjigjes së gabimit dhe menjëherë të rifillojë procesin e regjistrimit të gjendjes fillestare të parave cash në pajisjen elektronike të faturimit.

Tatimpaguesi NUK MUND TË FILLOJË PUNËN ME PAJISJEN ELEKTRONIKE TË FATURIMIT nëse regjistrimi i gjendjes fillestare të parave cash nuk është realizuar me sukses dhe nuk është bërë i vlefshëm.

Në raste të veçanta të përcaktuara me Ligj (kur ka dështim të lidhjes në internet ose nëse tatimpaguesi operon në zonë pa shërbim interneti), informacioni për gjendjen fillestare duhet të ruhet në memorien e pajisjes elektronike të faturimit, të jetë i nënshkruar në mënyrë elektronike, dhe të raportohet së bashku me procesin e fiskalizimit në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar. Nëse ka dështim të punës së pajisjes elektronike të faturimit, të dhënat e gjendjes shkruhen në bllokun e veçantë të faturave.

Gjendja fillestare e parave cash në arkë mund të jetë edhe zero lekë (0.00 lekë).

Regjistrimi i gjendjes fillestare së parave cash në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit që operon vetëm (pra, vetëm lëshon) fatura për transaksione pa para në dorë nuk kërkohet.


Regjistrimi fillestar lejohet vetëm një herë në ditë.

Nëse gjatë ditës operatori vendos para shtesë në pajisjen elektronike të faturimit ose tërheq disa para nga pajisja elektronike e faturimit për t'i vendosur ato në bankë etj., këto ndryshime gjithashtu regjistrohen në Administratën Tatimore përmes shërbimit të fiskalizimit në momentin kur ndodh ndryshimi:

- kur vendoset në pajisjen elektronike të faturimit një shumë shtesë e parave cash, tatimpaguesi duhet të regjistrojë shumën e re totale të parave cash, që i shtohet depozitës fillestare si "shtesë parash cash" dhe kjo shumë do t'i shtohet shumës fillestare të depozitës së parave cash të regjistruar; dhe / ose
- kur tërheq një sasi të caktuar parash cash nga pajisja elektronike e faturimit gjatë ditës së punës, tatimpaguesi duhet të regjistrojë vetëm shumën e "tërheqjes së parave cash" që është shuma e parave të tërhequra nga pajisja elektronike e faturimit.

Në çdo kohë, paratë cash (kartëmonedha dhe monedha) në pajisjen elektronike të faturimit duhet të jenë si më poshtë:

- ❖ depozita fillestare e parave cash e regjistruar
- ❖ + "shtesat e parave cash" të regjistruara
- ❖ + paratë cash nga shitjet e regjistruara (bazuar në faturat e lëshuara dhe të fiskalizuara)
- ❖ - "tërheqjet e parave cash" të regjistruara
- ❖ = paratë cash në pajisjen elektronike të faturimit




**Diagram 4 – Regjistrimi i gjendjes së parave në dorë në çdo ditë pune**

## 5.4 FISKALIZIMI I FATURAVE

Një tatimpagues që është përgjegjës për lëshimin e faturave dhe kryerjen e procesit të fiskalizimit, është i detyruar nga Ligji të fiskalizojë të gjitha faturat për transaksione me para në dorë dhe pa para në dorë. Fiskalizimi do të thotë që faturat e lëshuara, për transaksione me para në dorë dhe pa para në dorë, do të regjistrohen në bazën e të dhënave të Administratën Tatimore.

Fiskalizimi i faturave kryhet nëpërmjet shërbimit të fiskalizimit, që është përgjegjës për komunikimin e tatimpaguesve, të cilët lëshojnë fatura me Administratën Tatimore, për përpunimin e mesazheve të pranuar nga Administrata Tatimore si edhe për komunikimin me bankat, institucionet financiare jo-banka dhe me subjekte të tjera që sigurojnë shërbimin e pagimit të faturave elektronike.



*Diagrama 5 – Fiskalizimi i faturave*

#### 5.4.1 Fiskalizimi i faturave për transaksione me para në dorë

Fiskalizimi i faturave për transaksione me para në dorë mund të realizohet në mënyrat si më poshtë:

1. Përdorimi i shërbimit të fiskalizimit me anë të pajisjes elektronike të faturimit

2. Përdorimi i Platformës Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore (vetëm tatimpaguesit që përmbushin kriterin e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave)

3. Fiskalizimi i faturave për transaksione me para në dorë në Administratën Tatimore ose duke përdorur Platformën Qendrore të Faturave për ata tatimpagues që operojnë në zonën ku nuk ka lidhje interneti.

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e hollësishme e procedurës për fiskalizimin e faturave në të tre modelet e përmendura.

### **1. Fiskalizimi i faturave për transaksione me para në dorë duke përdorur një pajisje elektronike faturimi**

Procedura e fiskalizimit fillon kur tatimpaguesit i kërkohet të lëshojë një faturë për transaksione me para në dorë për mallrat ose shërbimet e dorëzuara. Tatimpaguesi krijon një mesazh XML (me elementë të faturës) duke përdorur pajisjen elektronike të faturimit. Pas krijimit të mesazhit, tatimpaguesi nënshkruan mesazhin XML me certifikatën e tij elektronike, që është marrë nga AKSHI, ose CA përkatëse. Mesazhi duhet të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar që përcaktohet në skemën XML.

Mesazhi i nënshkruar dërgohet në kanalin e përcaktuar të komunikimit të sistemit të informacionit të Administratës Tatimore. Sistemi i Administratës Tatimore merr një mesazh të nënshkruar XML dhe verifikon nënshkrimin elektronik si dhe strukturën e mesazhit XML.

Nëse mesazhi **KA KALUAR** validimin, ai ruhet në bazën e të dhënave të faturave të fiskalizuara (si të dhëna dhe mesazh në formatin e plotë XML). Pasi ruhet mesazhi XML, Platforma Qendrore të Faturave përmes shërbimit të fiskalizimit krijon një përgjigje me NIVF-në. Përgjigja nënshkruhet me një certifikatë elektronike të Administratës Tatimore dhe i dërgohet pajisjes elektronike të faturimit të tatimpaguesit. Pasi pajisja elektronike e faturimit merr përgjigjen e Administratës Tatimore, tatimpaguesi është i detyruar të printojë menjëherë faturën për transaksione me para në dorë me NIVF të marrë nga Administrata Tatimore dhe t'i dorëzojë ose t'ia japë faturën e printuar klientit.

Nëse mesazhi **NUK KA KALUAR** validimin, sistemi i informacionit i Administratës Tatimore (shërbimi i fiskalizimit) gjeneron një përgjigje XML me gabimin përkatës, i cili i dërgohet pajisjes elektronike të faturimit të tatimpaguesit. Tatimpaguesi është i detyruar që pas marrjes së përgjigjes së gabimit menjëherë të korrigjojë gabimin në sistemin e tij, dhe të rifiskalizojë faturën e pafiskalizuar. Nëse nuk është e mundur të korrigjohet menjëherë gabimi, duhet të lëshohet fatura pa NIVF dhe të zgjidhet problemi me pajisjen elektronike të faturimit në kohën e caktuar dhe më pas të fiskalizohen të gjitha faturat e pafiskalizuara përmes shërbimit të fiskalizimit.



## **2. Fiskalizimi i faturave për pagesa me para në dorë duke përdorur Platformën Qendrore të Faturave (CIP)**

Në rastet kur tatimpaguesi përmbush kriterin e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, mund të krijojë dhe fiskalizojë faturat e tij duke përdorur Platformën Qendrore të Faturave të Admininstratës Tatimore. Në këtë rast atij nuk i nevojitet të ketë një pajisje elektronike të faturimit, por vetëm një kompjuter ose tablet ose një pajisje smartphone që mund të përdoret për të hyrë në Platformën Qendrore të Faturave përmes lidhjes së internetit.

Tatimpaguesi do të jetë në gjendje të hyjë në Platformën Qendrore të Faturave duke përdorur një certifikatë elektronike, të lëshuar nga AKSHI.

Pas hyrjes në Platformën Qendrore të Faturave, tatimpaguesi do të duhet të vendosë të dhënat për vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, dhe poshte informacionit të operatorit, do të shfaqen automatikisht emri dhe mbiemri i tij, ose nëse ai është një person fizik, ose nëse është person juridik ai duhet të regjistrojë individin, i cili lëshon fatura si operator. Tatimpaguesi nuk do të duhet të instalojë softuer specifik të certifikuar për fiskalizimin në kompjuterin / pajisjen e tij smartphone. Në këtë rast nuk do të jetë e nevojshme që tatimpaguesi të konfirmojë të dhënat për prodhuesin dhe as të dhënat për mirëmbajtësin të softuerit.

Pasi Platforma Qendrore e Faturave krijon kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe kodin e operatorit, këto kode do të ruhen në bazën e të dhënave në llogarinë e përdoruesit të tij në Platformën Qendrore të Faturave.

Pas kësaj ai mund të krijojë një faturë të re në Platformën Qendrore të Faturave duke zgjedhur atë opsion të menusë në Platformën Qendrore të Faturave. Do të krijohet modeli i faturës së thjeshtë me të dhënat ekzistuese të vendosura me parë nga regjistri i tatimpaguesve i mbajtur në Administratën Tatimore. Tatimpaguesi duhet të vendosë të gjithë elementët e tjerë të detyrueshëm sipas skemës.

Pasi vendos të dhënat, ai do t'i konfirmojë ato dhe do t'i dërgojë në shërbimin e fiskalizimit (në Platformën Qendrore të Faturave). Pasi bëhet procesi i fiskalizimit, të dhënat do të ruhen në bazën e të dhënave dhe Platforma Qendrore e Faturave do të krijojë përgjigjen me NIVF-në. Kjo përgjigje do të nënshkruhet me certifikatën elektronike të Administratës Tatimore dhe do t'i dërgohet tatimpaguesit dhe automatikisht do të ruhet në faturën e krijuar dhe në dosjen e faturave të fiskalizuara në llogarinë e tij si përdorues. Pas marrjes së përgjigjes, tatimpaguesi duhet të printojë faturën për transaksionet me para në dorë me NIVF-në dhe t'ia japë këtë faturë blerësit ose do ta dërgojë me anë të emailit të tij si në situatat specifike, siç janë përcaktuar nga Ligji.

NIVF-ja do të krijohet sipas rregullave të përshkruara në IDENTIFIKUESIN UNIK IDENTIFIKUESIN UNIK TË FATURËS (NIVF).

### **3. Fiskalizimi i faturave për transaksione me para në dorë në Administratën Tatimore**

Në rastin kur tatimpaguesi operon në ambientin ku nuk është e disponueshme lidhja e përhershme e internetit dhe tatimpaguesi nuk mund të hyjë në Platformën Qendrore të Faturave duhet të sjellë të gjitha faturat e pafiskalizuara në zyrën lokale të Administratës Tatimore, në media portative (USB ose në CD të rishkrueshme ose pajisje të jashtme memorie) dhe t'ia japë ato zyrtarit të Administratës Tatimore që do të fiskalizojë këto fatura duke përdorur aplikacionin e portalit CPCM.

Secila Pajisje Elektronike e Faturimit duhet të jetë në gjendje të sigurojë funksionimin e kopjimit / eksportimit të faturave të pafiskalizuara në një memorie portative në formatin e përshkruar sipas specifikimeve teknike. Faturat në memorien portative duhet të ruhen individualisht dhe elektronikisht të nënshkruara nga certifikata elektronike e tatimpaguesit.

Pasi tatimpaguesi kopjon faturat e pafiskalizuara në një memorie portative në një format XML, është e nevojshme të shkojë në zyrën lokale tatimore. Pas mbërritjes, tatimpaguesi është i detyruar të sigurojë një memorie portative me faturat e pafiskalizuara të ruajtura, të lëshuara muajin e kaluar, për zyrtarin e Administratës Tatimore. Pas kësaj, zyrtari merr memorien portative, e lidh me kompjuterin dhe fillon procesin e ngarkimit të të dhënave. Pasi sistemi informatik i Administratës Tatimore të njohë memorien dhe mesazhet XML që përmbajnë faturat, sistemi do të verifikojë nënshkrimin elektronik të tatimpaguesit dhe strukturën e mesazheve XML përmes shërbimit standard të fiskalizimit.

Në momentin kur tatimpaguesi nënshkruan në mënyrë elektronike mesazhin XML në një modul "offline" për faturat e muajit të kaluar, ky nënshkrim nuk do të verifikohet për validimin e certifikatës deri sa të vendoset lidhja në internet, që mundëson që validimi i certifikatës mund të konfirmohet. Kjo do të thotë se në rast se tatimpaguesi nënshkruan mesazh në mënyrë elektronike me një datë 5.5.2020 dhe ia dorëzon zyrës së administratës tatimore më 8.5.2020, në rast se ajo certifikatë ka skaduar në 6.5.2020 do të ketë një gabim gjatë validimit të mesazhit dhe faturat nuk do të fiskalizohen.

Meqenëse të gjithë zyrtarët e Administratës Tatimore do të regjistrohen kur përdorin shërbimin e fiskalizimit, sistemi do të ketë informacione për secilin zyrtar të Administratës Tatimore dhe kur ngarkohen të dhënat për faturat të pa fiskalizuara.

Në rast se ky **është i vlefshëm**, sistemi do të fiskalizojë të gjitha faturat e paraqitura dhe do të krijojë NIVF-të individualisht për secilën faturë. Zyrtari i Administratës Tatimore do të ruajë mesazhin e përgjigjes në media portative dhe do t'ia kthejë atë tatimpaguesit. Ky mesazh do të jetë i dukshëm edhe në menunë e mesazheve të tatimpaguesit, në llogarinë e tij të përdoruesit në CIP (Platformën Qendrore të Faturave). Pasi zyrtari i Administratës Tatimore kthen memorien portative, tatimpaguesi duhet që brenda një periudhe prej 5 ditësh të ngarkojë këtë përgjigje të Administratës Tatimore (me fatura të

fiskalizuara) në pajisjen elektronike të faturimit. Pas kësaj, me kërkesë të klientit, tatimpaguesi duhet të lëshojë një kopje të një fature me NIVF të dukshëm.

Nëse **nuk është i vlefshëm**, sistemi i informacionit të Administratës Tatimore automatikisht do të gjenerojë një përgjigje me listën e gabimeve për të cilat fiskalizimi i faturave është i pamundur. Ky mesazh do të jetë i dukshëm edhe në menunë e mesazheve të tatimpaguesit në llogarinë e tatimpaguesit në Platformën Qendrore të Faturave. Zyrtari i Administratës Tatimore do të ruajë mesazhin e gabimit në memorien portative dhe ia kthen atë tatimpaguesit. Në këtë rast, tatimpaguesi duhet të korrigjojë gabimet dhe të përsërisë procedurën.

Afatet e fiskalizimit përcaktohen me Ligj dhe tatimpaguesit i kërkohet të bëjë fiskalizimin deri më datën 10-të të muajit për gjitha faturat e lësuara në muajin paraardhës.

Përndryshe, në vend që të dërgojë memorien portative në Administratën Tatimore, ai mund të ngarkojë vetë informacionin e faturës, pra skedarin XML me informacionin në lidhje me faturat e lësuara dhe jo të fiskalizuar, në Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore, që ai të mund të përdorë certifikatën elektronike në vendin ku është e arritshme një lidhje interneti. Platforma Qendrore e Faturave do të ketë një funksion të veçantë për ngarkimin e të dhënave mbi faturat e pafiskalizuar, të lësuara në muajin paraardhës, të disponueshëm vetëm për ata tatimpagues të cilët, përpara lëshimit të faturës, do të njoftojnë Administratën Tatimore, që ata po veprojnë në një zonë ku lidhja në internet nuk mund të vendoset dhe ky informacion do të ruhet në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore dhe në regjistrin e tatimpaguesve.

Gjithashtu, në rast se tatimpaguesi ka një pajisje elektronike të faturimit të lëvizshme, ai do të jetë në gjendje të kryejë një proces fiskalizimi duke lidhur pajisjen elektronike të faturimit në Internet në vendin më të afërt ku lidhja e internetit është e disponueshme (*për shembull, duke u lidhur me një wifi në një zyrë postare, një restorant, etj*) dhe nga pajisja elektronike e faturimit e tij të kryejë procesin e mëvonshëm të fiskalizimit të faturave të lësuara dhe të pafiskalizuar.

#### 5.4.2 Fiskalizimi i faturave për transaksione pa para në dorë

Fiskalizimi i faturave për transaksione pa para në dorë mund të realizohet në mënyrat e dhëna më poshtë:

1. Duke përdorur shërbimin e fiskalizimit përmes çdo pajisje elektronike në të cilën është instaluar zgjidhja softuerike për fiskalizimin, ose përmes përdorimit të Aplikacionit Cloud për fiskalizimin,
2. Duke përdorur Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore për të gjithë tatimpaguesit, të cilët përmbushin kriterin e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe për ata tatimpagues që operojnë në vende ku nuk ka lidhje interneti, ose
3. Me fiskalizimin e faturave për transaksione pa para në dorë në Administratën Tatimore për ata tatimpagues, që operojnë në një zonë ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje interneti dhe nuk mund të aksesohet Platforma Qendrore e Faturave.

Procedura e fiskalizimit të faturave për transaksione pa para në dorë është njësoj si për faturat për transaksione me para në dorë, e përshkruar në kapitullin më parë. Ndryshimet mes këtyre dy lloj faturash janë si vijon:

- mënyra e pagesës është e ndryshme, siç tregohet në faturë,
- afatet e pagesës janë përgjithësisht të ndryshme, dhe në faturat për transaksione me para në dorë në shumicën e rasteve, lëshimi i faturës dhe afati i pagesës janë të njëjta, ndërsa në faturat për transaksione pa para në dorë, periudha e pagesës, në shumicën e rasteve është pas datës së lëshimit të faturës (përveç se në rastin e parapagimit),
- faturat për transaksione me para në dorë duhet të printohen në letër dhe t'i dorëzohen blerësit (me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga Ligji kur ato gjithashtu mund të dërgohen me postë elektronike), ndërsa faturat për transaksione pa para në dorë në B2B dhe B2G lëshohen detyrimisht, dhe dorëzohet si faturë elektronike dhe në transaksionin pa para në dorë B2C fatura mund të printohet në letër ose në formë elektronike, prandaj kjo mbetet në vullnetin e shitësit që të zgjedhë mënyrën e dorëzimit të faturës (me pëlqimin e detyrueshëm të blerësit nëse është dorëzim elektronik),
- për faturat për transaksione me para në dorë, është i detyrueshëm regjistrimi i pajisjes elektronike të faturimit nga pika e shitjes së mallrave ose shërbimeve, ndërsa për faturat për transaksione pa para në dorë nuk ka asnjë detyrim të tillë,
- nuk është e detyrueshme të raportohet gjendja fillestare e parave cash në fillim të ditës së punës me fatura për transaksione pa para në dorë,
- Ligji 9920 përcakton shumën maksimale të pagesës për transaksione me para në dorë ndërmjet dy tatimpaguesve (150,000 lekë me TVSH të përfshirë), ndërsa nuk ka një kufi maksimal ose minimal për llogari të tillë për transaksione pa para në dorë,
- për transaksione me para në dorë nuk ka ndonjë raportim të veçantë ose regjistrim të pagesës së bërë (pasi kjo zakonisht bëhet menjëherë pas lëshimit të faturës), ndërsa fatura elektronike ka këtë detyrim për bankat, dhe intitucionet

financiare jo-banka dhe për tatimpaguesit, që vetë marrin pagesat e faturave elektronike të lëshuara në metodën tjetër të pagesave pa para në dorë,

- faturat për transaksione pa para në dorë të lëshuara për B2B dhe B2G, d.m.th. të gjitha ato të lëshuara në formën e një fature elektronike kanë informacion shtesë që duhet të vendosen në faturë.

## 5.5 FISKALIZIMI I FATURAVE KORRIGJUESE/SAKTËSUESE

Tatimpaguesi nuk mundet të anulojë ndonjë faturë për transaksione me para në dorë apo pa para në dorë, por nëse një mall i kthehet nga blerësi ose nëse diçka nuk shkon në faturën e lëshuar dhe fiskalizuar, tatimpaguesi mund të lëshojë një faturë korrigjuese me referencë në faturën fillestare (origjinale), që është duke u korrigjuar. Në rastin kur nuk ka lidhje interneti tatimpaguesi së pari duhet të fiskalizojë faturën origjinale dhe më pas faturën korrigjuese.

Nëse tatimpaguesi lëshon një faturë debiti korrigjuese ose një faturë krediti korrigjuese, atëherë vetëm ndryshimet përfshihen në faturë (për shembull vetëm artikujt që janë duke u ndryshuar, siç përshtrohet në Udhëzim Nr. 16, datë 03.04.2020 “Për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit”),. Nëse tatimpaguesi duhet të ndryshojë elementë të tjerë të faturës të cilat janë të pasakta, atëherë së pari duhet të lëshojë një faturë korrigjuese me të gjithë elementet e njëjtë si në faturën origjinale (*përveç datës së lëshimit dhe numrit të faturës, të cilat janë elemente që lidhen me vetë faturën korrigjuese*) dhe e gjithë shuma duhet të jetë negative; dhe pas kësaj duhet të lëshojë një faturë të re me të dhëna të sakta dhe duke iu referuar NSLF-së të faturës së parë të lëshuar.

Për shembull, në 1.10.2020 lëshohet fatura me numër 1-2020, por NIPT-i i blerësit në atë faturë të parë ishte i gabuar, kështu që tatimpaguesi ka bërë në datën 15.10.2020 lëshuar një faturë korrigjuese nr.2/2020 me referencë në faturën e parë të lëshuar 1.10.2020 (pra, NSLF e asaj fature duhet të tregohet në faturën korrigjuese dhe t'i dërgohet Administratës Tatimore në mesazhin XML sipas pikës 7.5 të këtij Specifikimi), me të gjithë elementët e tjerë të njëjtë si në faturën e parë nr. 12020., por të gjitha shumat duhet të jenë negative (përveç çmimit për njësi). Në të njëjtën datë 15.10.2020., lëshohet një faturë e re nr. 3/2020 me NIPT të saktë dhe me të gjitha të dhënat njësoj si në faturën nr.1 / 2020 dhe kjo faturë e tretë duhet të ketë një referencë në NSLF-në e faturës së parë të lëshuar nr. 1/2020. Të tre faturat duhet të fiskalizohen në momentin e lëshimit. Nëse tatimpaguesi fiskalizon faturën nr. 3/2020 dhe nuk fiskalizon faturën nr. 2/2020, atëherë do të marrë një gabim/njoftim nga sistemi i informacionit i Administratës Tatimore se nuk është fiskalizuar një faturë korrigjuese për faturën nr.1 / 2020, që do të thotë se në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore shumat e deklaruara në faturë nr. 1/2020 do të jetë në terma praktikë të dyfishuar, pasi asnjë korrigjim nuk kryhet dhe regjistrohet. Në atë rast tatimpaguesi do të duhet të fiskalizojë faturën korrigjuese nr.2 për të regjistruar të dhënat e sakta dhe korrekte në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore.

Nëse tatimpaguesi duhet të lëshojë një faturë korrigjuese, është e nevojshme të bëjë sa vijon:

### **1. Në rastin e faturës për transaksione me para në dorë:**

Në pajisjen elektronike të faturimit me të cilën u krijua fatura (*në rast se faturat ruhen lokalisht në pajisjen elektronike të faturimit të tatimpaguesit*), është e nevojshme të fillohet lëshimi i një procedure korrigjuese të faturës. Nëse tatimpaguesi ka një databazë qendrore të të gjitha faturave të lëshuara, korrigjimi i faturës mund të fillohet nga çdo pajisje elektronike e faturimit. Pas fillimit të procedurës së korrigjimit, shërbimi i fiskalizimit gjeneron një mesazh XML në të njëjtën mënyrë si për faturën fillestare (origjinale). Mesazhi XML për korrigjimin e faturës duhet të përmbajë:

#### **a. NSLF-në e faturës origjinale që është korrigjuar**

#### **b. Të gjithë elementët e përshkruar si për faturën origjinale**

Mesazhi XML nënshkruhet nga certifikata elektronike e tatimpaguesit dhe i dërgohet sistemit të informacionit në Administratën Tatimore – Platformës Qendrore të Faturave. Pasi mesazhi XML është marrë nga Administrata Tatimore, kryhen vlerësimet e mëposhtme:

a. nëse mesazhi është nënshkruar siç duhet me një certifikatë elektronike të vlefshme


b. nëse mesazhi është marrë në përputhje me skemën XML

Nëse mesazhi XML vlerësohet me sukses, sistemi i informacionit të Administratës Tatimore gjeneron NIVF-në për faturën korrigjuese dhe e dërgon atë në pajisjen elektronike të faturimit të tatimpaguesit. Menjëherë pas kësaj sistemi i Administratës Tatimore nis verifikimin e tij duke kërkuar në bazën e të dhënave të të gjitha faturave me kriteret e IUU dhe NSLF që përmban mesazhi XML të faturës korrigjuese të regjistruar. Në rast se nuk gjendet një faturë fillestare (origjinale) në bazën e të dhënave të faturës, sistemi i informacionit të Administratës Tatimore do të gjenerojë përgjigjen me mesazhin e gabimit, që ka ndodhur një gabim në procedurën e korrigjimit dhe do t'ia dërgojë atë tatimpaguesit në llogarinë e përdoruesit në Platformën Qendrore të Faturave. Tatimpaguesi duhet të korrigjojë gabimin (pra. fiskalizimin e faturës fillestare). Nëse fatura korrigjuese është e pasaktë, atëherë fatura korrigjuese e kësaj fature korrigjuese duhet të lëshohet dhe fiskalizohet me referencë tek ajo faturë korrigjuese “e gabuar” dhe duhet të lëshohet dhe të fiskalizohet një faturë e re korrigjuese me referencë në faturën fillestare (origjinale).

### **2. Në rastin e faturës për transaksione pa para në dorë:**

Procedura e korrigjimit të faturës mund të nisë nga çdo kompjuter duke përdorur një zgjidhje softuerike për fiskalizim. Procedura për fiskalizimin e faturës korrigjuese për

transaksione pa para në dorë është e njëjtë, si në rastin e faturës korrigjuese për transaksione me para në dorë.



*Diagram 6 – Fiskalizimi i faturës korrigjuese*



## 5.6 FISKALIZIMI I FATURËS SHOQËRUESE

Tatimpaguesi që është i detyruar të lëshojë faturë shoqëruese, është i detyruar nga Ligji të fiskalizojë të gjitha faturat shoqëruese, të cilat përdoren si një dokumentacion mbështetës transporti gjatë transferimit të mallrave midis magazinave të tatimpaguesit ose midis magazinave dhe pikave të shitjes. Fiskalizimi nënkupton që të gjitha faturat shoqëruese, për të gjitha mallrat e transferuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore.

Fiskalizimi i faturës shoqëruese kryhet duke përdorur shërbimin e fiskalizimit të Platformës Qendrore të Faturave, që siguron komunikim ndërmjet tatimpaguesit dhe Administratës Tatimore dhe përpunimin e të gjitha mesazheve të dërguara nga tatimpaguesi drejt Administratës Tatimore.

Fiskalizimi i faturës shoqëruese mund të realizohet nëpërmjet shërbimit të fiskalizimit duke përdorur një pajisje elektronike me një zgjidhje softuerike të certifikuar për fiskalizimin.

Procedura e fiskalizimit fillon kur tatimpaguesit i kërkohet të lëshojë një faturë shoqëruese për transferimin e mallrave ndërmjet magazinave ose në pikat e shitjes. Tatimpaguesi krijon një mesazh XML (me elementë të faturës shoqëruese) duke përdorur një pajisje elektronike me softuer për fiskalizimin e faturës shoqëruese. Pas krijimit të mesazhit, tatimpaguesi nënshkruan mesazhin XML me certifikatën e tij elektronike, që ka marrë nga AKSHI. Mesazhi duhet të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar, që përcaktohet në skemën XML.

Mesazhi i nënshkruar shkon në kanalin e përcaktuar të komunikimit me sistemin e informacionit të Administratës Tatimore. Sistemi i Administratës Tatimore merr një mesazh të nënshkruar XML dhe verifikon nënshkrimin elektronik dhe strukturën e mesazhit XML.

Nëse mesazhi **është i vlefshëm** (ka kaluar vlershmërinë), ai ruhet në bazën e të dhënave të faturave shoqëruese të fiskalizuara (si të dhëna dhe mesazh në formatin e plotë XML). Pasi të ruhet mesazhi XML, Platforma Qendrore e Faturave përmes shërbimit të fiskalizimit, krijon një përgjigje me NIVFSH. Përgjigja nënshkruhet me një nënshkrim elektronik të Administratës Tatimore dhe përgjigja i dërgohet pajisjes elektronike të tatimpaguesit. Pasi pajisja elektronike të marrë përgjigjen e Administratës Tatimore, tatimpaguesit i kërkohet që menjëherë të printojë kodin QR, që mban të dhënat e faturës shoqëruese të lëshuar dhe të regjistruar në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore, ta dorëzojë dhe ta ruajë atë në një formë elektronike në magazinën prej së cilës dalin mallrat.

Nëse mesazhi **nuk është i vlefshëm**, nga sistemi i informacionit i Administratës Tatimore, (shërbimi i fiskalizimit) gjeneron një përgjigje XML me gabimin përkatës dhe e dërgon atë në pajisjen elektronike e tatimpaguesit. Tatimpaguesi është i detyruar, që menjëherë të korrigjojë gabimin në sistemin e tij pas marrjes së përgjigjes së gabimit



## 5.7 KRIJIMI DHE KONTROLLI I KODIT QR

Për të siguruar lehtësisht verifikimin e faturës së fiskalizuar, një kod QR duhet të printohet në çdo faturë të lëshuar. Kodi QR printohet si në rastin kur fatura raportohet me sukses në Administratën Tatimore dhe fiskalizohet (fatura ka marrë NIVF), si edhe në rastin kur fatura nuk mund të fiskalizohet (mungesa e internetit, mosdisponueshmëria e shërbimit të fiskalizimit, etj.).

Kodi QR do të printohet në letër për të gjitha faturat e transaksioneve me para në dorë, ndërsa për faturat elektronike kodi QR duhet të jetë bashkëlidhur me dosjen e faturave elektronike dhe duhet të printohet në letër vetëm në rast të dorëzimit të mallrave, kur kodi QR i printuar shërben si një dokument transportues mbështetës për mallrat e furnizuara.

Për detaje se si gjenerohet kodi QR nga pajisja elektronike e faturimit dhe verifikohet nga klienti, ju lutem, referoju specifikimeve teknike të shërbimit të fiskalizimit.

Qytetari ose inspektori i tatimeve mund të skanojë kodin QR në faturë me aplikacionin e duhur në telefonat ose tabletët e tyre smart dhe do të drejtohet në faqen e vleshmërisë të Platformës Qendrore të Faturave për të konfirmuar statusin e fiskalizimit të faturës.

Disa rezultate janë të mundshme:

1. Fatura regjistrohet në bazën e të dhënave - faqja e verifikimit do të kthejë elementet origjinale të faturës të lidhur me këtë NIVF. Qytetari/inspektori i tatimeve mund të vlerësojë, që përmbajtja e ruajtur në bazën e të dhënave në Platformën Qendrore të Faturave është e njëjtë me atë të printuar në faturë.
2. Fatura nuk gjendet në bazën e të dhënave, por fatura është lëshuar në 48 orët e fundit - tatimpaguesi ka 48 orë afat kohor për të fiskalizuar faturën. Edhe pse fatura nuk është gjetur në bazën e të dhënave, një veprim i tillë nuk quhet domosdoshmërisht një shkelje.
3. Fatura që nuk gjendet në bazën e të dhënave dhe fatura është më e vjetër se 48 orë - në rast se lëshuesi / tatimpaguesi ka aprovimin për fiskalizim të vonë (duke punuar në zonë pa lidhje interneti), fatura mund të rishikohet brenda një muaji.
4. Fatura që nuk gjendet në bazën e të dhënave dhe fatura është më e vjetër se 48 orë - në rast se fatura nuk është gjetur dhe kanë kaluar më shumë se 48 orë dhe tatimpaguesi nuk ka një aprovim për fiskalizim të vonë, qytetari / inspektori i tatimeve do të marrë përgjigje që fatura nuk është e regjistruar në bazën e të dhënave dhe kjo duhet të raportohet në Administratën Tatimore duke përdorur të njëjtin aplikacion, kështu që kjo faturë do të dërgohet për një analizë të hollësishme. Pas raportimit, kjo faturë do t'i dërgohet automatikisht inspektorit tatimor përgjegjës për verifikimin e fushës ose departamentit të hetimit tatimor / kontrollit tatimor për analiza të mëtejshme. Kjo faturë, p.sh. tatimpaguesi ka shumë të ngjarë të jetë duke kryer shkelje.

5. Fatura nuk është e vlefshme - në rast se NSLF nuk është formuar siç duhet, gabimi do të shfaqet. Ky gabim tregon se fatura është e dyshimtë dhe mund të analizohet më tej siç përshkruhet në pikën 4.

## 5.8 VERIFIKIMI I NSLF-SË NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË FATURIMIT

Për qëllime të hetimit tatimor, çdo program fiskalizimi i instaluar në pajisjen elektronike të faturimit duhet të jetë në gjendje të lejojë rikrijimin e NSLF bazuar në parametrat fillestarë të formimit të NSLF-së.

Kjo veprimtari kontrolli mund të kryhet nga inspektorët e tatimeve gjatë procedurës së hetimit kur me kërkesë të inspektorit të tatimeve, operatori duhet të jetë në gjendje të rikrijojë NSLF në pajisjen elektronike të faturimit (për shembull kur bazuar në kodin e skanuar QR nga një qytetar, fatura nuk regjistrohet në bazën e të dhënave, d.m.th. nuk ka kaluar procedurën e fiskalizimit dhe inspektori duhet të kontrollojë dhe të vërtetojë nëse kjo faturë e raportuar është lëshuar me të vërtetë nga tatimpaguesi i deklaruar në faturë).

Çdo softuer i pajisjes elektronike të faturimit duhet të ketë një funksion në ekranin e punës, që lejon vendosjen e parametrave të nevojshëm për formimin e NSLF, sipas fushave përkatëse:

- NIPT-in e tatimpaguesit
- Datën dhe orën e lëshimit të faturës
- Numrin e faturës
- Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Kodin e ECD-së
- Kodin e softuerit
- Shumën totale të faturës

Sapo të hidhen këto të dhëna, softueri i pajisjes elektronike të faturimit mund të krijojë NSLF duke përdorur këto parametra dhe nënshkrimin elektronik të tatimpaguesit.

NSLF i gjeneruar duhet të jetë i njëjtë për të njëjtat parametra hyrës. Kjo mund të përdoret për të verifikuar NSLF-të e printuara në fatura të veçanta në të kaluarën.

Kështu për shembull nëse NSLF i gjeneruar është i njëjtë me atë të raportuar nga qytetari / blerësi, inspektori tatimor mund ta përdorë atë si provë që tatimpaguesi ka shkelur Ligjin sepse nuk e ka regjistruar faturën në sistemin e fiskalizimit, dhe mundet që menjëherë të përcaktojë një dënim për kundravajtje.

## 6. RREGULLAT E PUNËS

### 6.1 PROCESI I REGJISTRIMIT TË PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT DHE SOFTUERIN E FISKALIZIMIT PËR FATURAT ME TRANSAKSIONE ME PARA NË DORË

Kodi	Rregullat
	Çdo pajisje elektronike e faturimit duhet të regjistrohet individualisht
	Gjatë regjistrimit të pajisjes elektronike të faturimit është e nevojshme të regjistrohet edhe softueri i pajisjes elektronike të faturimit
	Regjistrimi i pajisjes elektronike të faturimit mund të bëhet vetëm një herë për secilën pajisje elektronike të faturimit të veçantë
	Pas marrjes së mesazhit të regjistrimit për pajisjen elektronike të faturimit, Platforma Qendrore e Faturave automatikisht gjeneron një kod unik dhe të papërsëritshëm për çdo pajisje elektronike të faturimit dhe ruan të dhënat në programin e përdorur të pajisjes elektronike të faturimit e përdorur në bazën e të dhënave
	Pas regjistrimit të suksesshëm dhe marrjes së përgjigjes nga Administrata Tatimore që përmban kodin unik të pajisjes elektronike të faturimit, tatimpaguesi është i detyruar të ruajë këtë kod në programin e përdorur nga pajisja elektronike e faturimit dhe ta përdorë atë për çdo lëshim fature.
	Kodi i pajisjes elektronike të faturimit është një pjesë e detyrueshme e NSLF që gjenerohet në çdo lëshim fature dhe është informacion i detyrueshëm për të gjitha faturat për transaksione me para në dorë.
	NSLF nuk mund të gjenerohet nëse fatura nuk përmban kodin e pranuar të pajisjes elektronike të faturimit.
	Kodi i pajisjes elektronike të faturimit do të jetë i dukshëm për tatimpaguesin në llogarinë e tij si përdorues në Platformën Qendrore të Faturave
	Nëse në vendin e ushtrimit të veprimtarisë të biznesit ku pajisja elektronike e faturimit është regjistruar si e mbyllur përgjithmonë duhet të çregjistrohet. Heqja e regjistrimit mund të bëhet me anë të shërbimit të fiskalizimit direkt nga pajisja elektronike e faturimit ose me anë të Platformës Qendrore të Faturave. Nëse e njëjta pajisje elektronike e faturimit do të përdoret në një tjetër vend ushtrimi të veprimtarisë së biznesi është për t'u regjistruar përsëri si një pajisje elektronike e faturimit dhe do të marrë një kod të ri të Pajisjes Elektronike të Faturimit.

### 6.2 PROCESI I REGJISTRIMIT PËR SOFTUERIN E FISKALIZIMIT PËR FATURAT PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË DHE PËR FATURAT SHOQËRUESE

Kodi	Rregull
	Është e nevojshme të regjistrohet çdo softuer që mbështet shërbimin e fiskalizimit dhe lëshon fatura për transaksione pa para në dorë / fatura shoqëruese
	Regjistrimi bëhet para lëshimit të faturës së parë, për transaksione pa para në dorë / faturës shoqëruese në mesazhin XML së bashku me elementët e

	detyrueshëm të faturës
	Pas regjistrimit të suksesshëm, informacioni i softuerit ruhet në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore
	Sa herë që lëshohet një faturë për transaksione pa para në dorë / faturë shoqëruese, kodi i softuerit është element i detyrueshëm i përdorur për gjenerimin e NSLF ose NSLFSH dhe i dorëzohet përmes shërbimit të fiskalizimit të Administratës Tatimore, së bashku me elementë të tjerë të faturës / faturës shoqëruese - gjatë procesit të fiskalizimit
	Shërbimi i fiskalizimit i Administratës Tatimore për secilën faturë për transaksione pa para në dorë / faturë shoqëruese, mes elementeve të tjerë, kontrollon edhe kodin e softuerit që përdor tatimpaguesi (verifikimi pasues, jo në kohë reale) dhe çdo ndryshim regjistrohet në bazën e të dhënave.

### 6.3 REGJISTRIMI I GJENDJES TË PARAVE CASH NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË FATURIMIT (ARKË)

Kodi	Rregull
	Një tatimpaguesi i kërkohet të raportojë gjendjen fillestare të parave cash në pajisjen elektronike të faturimit para fillimit të veprimeve të pajisjes elektronike të faturimit çdo ditë.
	Procedura e regjistrimit të gjendjes fillestare bëhet individualisht për secilën pajisje elektrike të faturimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.
	Regjistrimi i gjendjes fillestare kërkohet edhe kur gjendja fillestare është 0.00 lekë.
	Pajisja elektronike e faturimit nuk mund të fillojë të funksionojë nëse nuk regjistrohet asnjë gjendje fillestare.
	Tatimpaguesit i kërkohet të raportojë çdo hyrje të parave cash dhe çdo dalje të parave cash nga pajisja elektronike e faturimit gjatë ditës.
	Për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të cilët punojnë 0-24, gjendja fillestare do të regjistrohet çdo ditë menjëherë pas 00.00 (mesnatë)
	Procedura e regjistrimit të gjendjes fillestare lejohet vetëm një herë në ditë.

### 6.4 FISKALIZIMI I FATURAVE PËR TRANSAKSIONE ME PARA NË DORË/FATURAVE SHOQËRUESE

Kodi	Rregull
	Të gjitha faturat për transaksione me para në dorë / faturat shoqëruese duhet të fiskalizohen
	Çdo faturë për transaksione me para në dorë / faturë shoqëruese duhet të ketë NSLF dhe NIVF/NSLFSH dhe NIVFSH.
	Të gjitha faturat e vlefshme për transaksione me para në dorë duhet të printohen në kohën e lëshimit dhe NIVF dhe NSLF dhe kodi QR duhet të printohen së bashku me elementet e tjerë të detyrueshëm të faturës përveç rasteve të veçanta të përcaktuara në Ligj.
	Për faturat shoqëruese mund të printohet vetëm kodi QR në kohën e lëshimit.
	Operatori i pajisjes elektronike të faturimit është një person i autorizuar nga tatimpaguesi për të lëshuar fatura për transaksione me para në dorë / fatura shoqëruese në pajisjen elektronike të faturimit

## 6.5 FISKALIZIMI E FATURAVE PËR TRANSAKSIONE PA PARA NË DORË

Kodi	Rregullat
	Të gjitha faturat për transaksione pa para në dorë duhet të fiskalizohen.
	Çdo faturë për transaksione pa para në dorë duhet të ketë një NSLF dhe NIVF.
	Për faturat për transaksione pa para në dorë janë të lëshuara për furnizimin e mallrave me transport, kodi QR i faturës duhet të printohet dhe ti dorëzohet transportuesit, i cili do ta mbajë deri në destinacionin e mallrave.
	Nuk ka asnjë të dhënë për kodin e pajisjes elektornike të faturimit për fiskalizimin e faturave për transaksione pa para në dorë.
	Çdo tatimpagues që lëshon faturë për transaksione pa para në dorë duhet të ketë të paktën një vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të regjistruar (vendi ku është regjistruar biznesi). Kodi i regjistruar i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është një pjesë e kërkuar e NSLF
	Kodi i operatorit është një identifikues i personit të autorizuar për lëshimin e faturës së tatimpaguesit. Në rastet kur faturat për transaksione pa para në dorë janë lëshuar nga shërbimet e kontabilitetit, kodi i operatorit është NIPT i tatimpaguesit i autorizuar për lëshimin e faturave.

## 6.6 VALIDIMI I FATURAVE PARA SE TË RUHEN NË DATABAZËN E PLATFORMËS QENDRORE TË FATURËS

Kodi	Rregullat
	Një mesazh që nuk është validuar me sukses nuk do të përpunohet nga Platforma Qendrore e Faturave ose ruhet në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore.
	Mesazhi duhet të përputhet me skemën XML të faturës.
	Tatimpaguesi është i detyruar të marrë një certifikatë elektronike nga AKSHI, me qëllim zbatimin e procesit të fiskalizimit.
	Mesazhi duhet të nënshkruhet siç duhet me certifikatën e aplikacionit.
	NIPT i tatimpaguesit nga mesazhi i kërkesës duhet të jetë i barabartë me NIPT nga certifikata elektronike e tatimpaguesit.

## 6.7 VALIDIMI I FATURAVE TË PRANUARA PASI JANË REGJISTRUAR NË DATABAZËN E PLATFORMËS QENDRORE TË FATURAVE

Kodi	Rregulli
	Çdo mesazh XML i pranuar ruhet nga Platforma Qendrore e Faturave. Arsyeja për ruajtjen e mesazhit është nevoja për të provuar kredibilitetin e mesazhit të pranuar XML.

## 6.8 FATURAT KORRIGJUESE

Kodi	Rregullat
	Fatura korrigjuese mund të lëshohet në kohën e ruajtjes së faturës (5 vjet duke filluar nga viti kur fatura është lëshuar).

	Së pari, fatura që është korigjuar duhet të fiskalizohet në Administartën Tatimore.
	Në rast se lidhja e Internetit është shkëputur, tatimpaguesi mund të lëshojë faturat vetëm me NSLF. Pasi të jetë vendosur lidhja në Internet, fatura duhet së pari të fiskalizohet (merrni NIVF) dhe vetëm atëherë mund të bëhet fiskalizimi i faturës korigjuese.
	Çdo faturë që lëshohet në mënyrë offline dhe korigjohet në mënyrë offline duhet të fiskalizohet (së pari nevojitet fiskalizimi i faturës së lëshuar dhe më pas mund të bëhet fiskalizimi i faturës korigjuese), përveç kur ato janë fiskalizuar në të njëjtën kohë.
	Fiskalizimi i një fature korigjuese, nëse fatura fillestare më parë nuk ishte fiskalizuar, do të konsiderohet një gabim.
	Nuk është e mundur të fshihet fatura e lëshuar, por thjesht të lëshohet një faturë korigjuese, e cila gjithashtu duhet të fiskalizohet dhe regjistrohet në Administratën Tatimore.



## 7. STRUKTURA E MESAZHEVE XML

Ky kapitull i dokumentit shpjegon me detaje përmbajtjen e mesazheve XML me atributet e tyre, si dhe kontrollet që zbatohen në atributet individuale.

### 7.1 STRUKTURA E MESAZHIT XML PËR REGJISTRIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT

TITULLI I MESAZHIT		
<b>FUSHË 1.</b> "UUID"	<b>IDENTIFIKUESI I MESAZHIT</b> <i>ID e mesazhit – formati UUID (Identifikuesi Unik Universal)</i>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 2.</b> "SendDateTime"	<b>DATA DHE ORA E DËRGIMIT TË MESAZHIT XML</b> <i>Kjo tregon datën e dërgimit të një mesazhi XML në Administratën Tatimore.</i>	Fushë e detyrueshme

PËRMBAJTJA E MESAZHIT		
<b>FUSHË 3.</b> "IssuerNUIS"	<b>NIPT I TATIMPAGUESIT</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 4.</b> "BusinUnitCode"	<b>KODI I VENDIT TË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË BIZNESIT</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 5.</b> "TCRIntID"	<b>NUMRI RENDOR I PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT (ID e brendshme)</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 6.</b> "SoftCode"	<b>KODI I SOFTUERIT I PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 7.</b> "MaintainerCode"	<b>KODI I MIRËMBAJTËSIT TË SOFTUERIT I PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 8.</b> "ValidFrom"	<b>DATA KUR DO TË FILLOJË PËRDORIMI I PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT</b>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 9.</b> "ValidTo"	<b>DATA KUR PAJISJA ELEKTRONIKE E FATURIMIT DO TË PËRDORET</b>	Fushë fakultative (është e detyrueshme vetëm në rastin e çrregjistrimit të Pajisjes Elektronike të Faturimit)
<b>FUSHË 10.</b> "Type"	<b>Lloji i pajisjes elektronike të faturimit</b> <i>A)normal</i> <i>b)pajisje vetë-shërbimit (automate)</i>	Fushë e detyrueshme

### 7.2 STRUKTURA E MESAZHEVE XML PËR REGJISTRIMIN E GJENDJES FILLESTARE TË PARAVE CASH

TITULLI I MESAZHIT		
<b>FUSHË 1.</b> "UUID"	<b>IDENTIFIKUESI I MESAZHIT</b> <i>ID e mesazhit – formati UUID (Identifikuesi Unik Universal)</i>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 2.</b> "SendDateTime"	<b>DATA DHE ORA E DËRGIMIT TË MESAZHIT XML</b> <i>Kjo tregon datën e dërgimit të një mesazhi XML në Administratën Tatimore.</i>	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 3.</b>	<b>Shuma e parave cash</b>	Fushë e detyrueshme

"CashAmt"		
FUSHË 4. "Operation"	<p><b>OPERACIONI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>INITIAL</b> – gjendja fillestare</li> <li>• <b>IN</b> – Shtesë parash cash</li> <li>• <b>OUT</b> – Tërheqje parash cash</li> </ul> <p>Depozita fillestare: Shuma e gjendjes së parave në dorë që tatimpaguesi ka vendosur në ECD në fillim të çdo dite pune. Depozita regjistrohet individualisht për secilën ECD në vendin e ushtrimit të veprimatarisë së biznesit. Tatimpaguesit janë të detyruar të kryejnë regjistrimin e depozitës së parasë edhe në rastin kur gjendja është 0.00 lekë.</p> <p>Shtimi i parave cash / tërheqje parash cash: Shuma e parave në dorë të shtuara në ECD gjatë ditës së punës, pas regjistrimit fillestar të gjendjeve të parave në dorë. Duhet të regjistrohet individualisht për secilën ECD në vendin e ushtrimit të veprimatarisë së biznesit.</p>	
FUSHË 5. "TCRCode"	<p><b>KODI I ECD</b></p> <p>Kodi i pajisjes elektronike të faturimit për të cilën gjendja është regjistruar</p>	Fushë e detyrueshme
FUSHË 6. "IssuerNUIS"	<p><b>NIPT</b></p> <p>NIPT-i i tatimpaguesit</p>	Fushë e detyrueshme
FUSHË 7. "Header.IsSubseqDeliv"	<p><b>REKORDI I DËRGIMIT TË MËVONSHËM I DEPOZUITËS SË PARAVE NË DORË</b></p> <p>Informacioni mbi depozitën e parave në dorë dorëzohet më pas, (ndërprerja e lidhjes në internet ose dëmtimi i plotë i ECD).</p> <p>Vlerat e mëposhtme janë të mundshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>E VERTETË</b> - informacioni jepet më pas</li> <li>- <b>FALSE</b> - nëse nuk është kështu.</li> </ul>	Fushë e detyrueshme

## 7.3 MESAZHI PËR FISKALIZIMIN E FATURËS

### 7.3.1 Mesazhi për fiskalizimin e faturave për transaksionet me para në dorë nëpërmjet Pajisjes Elektronike të Faturimit

#### TITULLI I MESAZHIT

<b>FUSHË 1.</b> <b>"UUID"</b>	<b>IDENTIFIKUESI I MESAZHIT</b> ID e mesazhit – formati UUID (Identifikuesi Unik Universal)	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 2.</b> <b>"SendDateTime"</b>	<b>DATA DHE ORA E DËRGIMIT TË MESAZHIT XML</b> Kjo tregon datën e dërgimit të një mesazhi XML në Administratën Tatimore.	Fushë e detyrueshme

#### PËRMBAJTJA E MESAZHIT

<b>FUSHË 3.</b> <b>"TypeOfInv"</b>	<b>LLOJI I FATURËS</b> Lloji i faturës përcakton atributet e faturës, nëse fatura është për transaksione me para në dorë ose jo. Ky atribut do të përdoret për të dalluar faturën në librin e shitjeve dhe blerjeve të tatimpaguesit. Vlera të mundshme: a. Faturë për transaksione me para në dorë – CASH b. Faturë për transaksione pa para në dorë – NONCASH	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 4.</b> <b>"TypeOfSelfss"</b>	<b>Lloji VETË-FATURIMI</b> Kjo fushë duhet të plotësohet me vlerat e mëposhtme të përcaktuara: a) marrëveshjen e mëparshme ndërmjet palëve b) blerjen nga fermerët vendas c) blerjen e shërbimeve nga jashtë d) të tjera.  Në rastin kur blerësi lëshon një faturë në vend të shitësit, fatura duhet të ketë një shënim: "vetë-faturim" dhe informacioni i blerësit është i detyrueshëm sepse blerësi lëshon faturën në emër të shitësit. Ekzistojnë disa raste të vetë-faturimit: kur ekziston një marrëveshje e ndërsjellë midis shitësit dhe klientit, kur shitësi nuk është i detyruar të lëshojë fatura, kur tatimpaguesi blen shërbimet nga shitësi nga jashtë etj.	Fushë e detyrueshme
<b>FUSHË 5.</b> <b>"IsSimplifiedInv"</b>	<b>ËSHTË FATURË E THJESHTË</b> <b>Vlerat e mëposhtme mund të futen:</b> - E VËRTET, nëse është një faturë e thjeshtë - FALSE, nëse nuk është një faturë e thjeshtë	
<b>FUSHË 6.</b> <b>"Seller.IDType"</b>	<b>LLOJI I NUMRIT TË ID TË SHITËSIT</b> Mund të futen vlerat e mëposhtme: • NIPT / NUIS, ose • ID (numri personal i identifikimit).  Nëse shitësi nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, atëherë duhet të zgjidhet një nga llojet e mëposhtme të numrit të identifikimit: • PASS (numri i pashaportcs), • TVSH (numri i regjistrimit për TVSH-në e lëshuar në vendin e rezidencës për personin e tatueshëm të huaj), • TATIMI (numri i tatimit të lëshuar në vendin e rezidencës për tatimpaguesit e huaj) • SOC (numri i sigurimeve shoqërore të lëshuar në vendin e rezidencës për tatimpaguesit e huaj).	Fushë e detyrueshme
	<b>NUMRI I ID SË SHITËSIT</b>  Bazuar në llojin e ID-së së shitësit të futur në fushën 5., numri i	Fushë e detyrueshme

FUSHË 7. "Seller.IDNum"	<p>kësaj ID do të futet në këtë fushë.</p> <p>Për personin e regjistruar / rezident në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohet NIPT (për person juridik dhe fizik) ose numrin personal i identifikimit (për individë). Shitësi është tatimpaguesi që lëshon faturën, pra, ai që furnizon mallrat ose shërbimet.</p> <p>Kërkohen kontrollet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A është ai i regjistruar në regjistrin e tatimpaguesve si tatimpagues - i detyruar për të lëshuar fatura (nëse nuk është i regjistruar, ai nuk mund të lëshojë faturë, përveç nëse kjo është një "vetë-faturim" dhe fatura lëshohet nga blerësi)</li> <li>- A është i regjistruar në regjistrin e tatimpaguesve pasiv (nëse është, ai nuk mund të lëshojë një faturë derisa të ndryshojë statusin e tij)</li> <li>- A është i regjistruar në regjistrin e paguesve të TVSH-së (nëse nuk është, ai nuk mund të lëshojë faturë TVSH, përveç nëse është një tarifë e kundërt).</li> </ul>	
FUSHË 8. "Seller.Name"	EMRI I SHITËSIT	Fushë e detyrueshme
FUSHË 9. "Seller.Address"	ADRESA E SHITËSIT	Fushë e detyrueshme për të huajt
FUSHË 10. "Seller.Town"	QYTETI I SHITËSIT	Fushë e detyrueshme për të huajt
FUSHË 11. "Seller.Country"	SHTETI I SHITËSIT	Fushë e detyrueshme për të huajt
FUSHË 12. "IssueDateTime"	<p><b>DATA DHE ORA E LËSHIMIT TË FATURËS</b></p> <p>Data dhe ora e lëshimit të faturës është një fushë e detyrueshme që përbëhet nga dy elementë:</p> <p>a. Data e lëshimit të faturës (DD/MM/YYYY)</p> <p>b. Ora e lëshimit të faturës(ora:minuta:sekonda)</p> <p>Data dhe ora e lëshimit të faturës ndahen me simbolin T (kohën).</p>	Fushë e detyrueshme
FUSHË 13. "InvNum"	<p><b>NUMRI I FATURËS</b></p> <p>Numri i faturës është fushë e detyrueshme për secilën faturë.</p> <p>Formati i numrit të faturës është përcaktuar në Udhëzimet për të siguruar se si duhet të shfaqet kur printohet.</p> <p>Të dhënat do t'i dërgohen Administratës Tatimore në XML për të siguruar përpunimin, analizën dhe raportimin më të lehtë.</p> <p>Numri i faturës do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:</p> <p><b>A. NUMRI RENDOR, NUMRI I FATURËS DHE VITI KALENDARIK</b></p> <p>Mund të mbajë numrat 0-9 . Pa u nisur nga 0.</p> <p><b>B. VITI KALENDARIK(YYYY)</b></p> <p><b>C. KODI I PAJISJES ELEKTRONIKE TË FATURIMIT</b></p> <p>Kodi Unik i Pajisjes Elektronike të Faturimit i regjistruar në Platformën Qendrore të Faturave</p>	Fushë e detyrueshme
FUSHË 14. "IsIssuerInVAT"	<p><b>STATUSI I TATIMPAGUESIT</b></p> <p>Vlerat e mundshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tatimpaguesi është regjistruar për TVSH – 1</li> <li>2. Tatimpaguesi nuk është regjistruar për TVSH – 2</li> </ol>	Fushë e detyrueshme
FUSHË 15. "Buyer.IDType"	<p><b>LLOJI I NUMRIT TË ID-SË SË BLERËSIT</b></p> <p>Mund të futen vlerat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• NIPT / NUIS, ose</li> <li>• ID (numri personal i identifikimit).</li> </ul> <p>Nëse blerësi nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, atëherë duhet të zgjidhet një nga llojet e mëposhtëm të numrit të identifikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• PASS (numri i pasaportës),</li> <li>• TVSH (numri i rregjistrimit për TVSH-në e lëshuar në vendin e rezidencës për personin e tatueshëm të huaj),</li> <li>• TATIMI (numri i tatimit të lëshuar në vendin e</li> </ul>	Fusha fakultative (E detyrueshme në transaksionet B2B dhe situatë tjetër e veçantë)

	<ul style="list-style-type: none"> <li>rezidencës për tatimpaguesit e huaj),</li> <li>SOC (numri i sigurimeve shoqërore të lëshuar në vendin e banimit për tatimpaguesit e huaj).</li> </ul>	
<b>FUSHË 16.</b> <b>"Buyer.IDNum"</b>	<p><b>NUMRI ID I BLERËSIT</b></p> <p>Bazuar në llojin e ID-së së blerësit të vendosur në fushën 14., numri i kësaj ID do të vendoset në këtë fushë.</p> <p>Për personin e regjistruar / rezident në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohet NIPT (për person juridik dhe fizik) ose numrin personal i identifikimit (për individë).</p> <p>Kjo fushë plotësohet nëse blerësi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tatimpagues i një subjekti të tatimit mbi fitimin ose i tatimit të thjeshtuar mbi fitimit për bizneset e vogla ose një tatimpaguesi që është subjekt i TVSH-së në përputhje me rregulloret e veçanta, ose</li> <li>një person juridik, të cilit i ofrohen mallra ose shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike; ose</li> <li>nëse prona personale me një vlerë shitjeje mbi 500,000 lekë;</li> <li>ose në raste të tjera kur blerësi kërkon, që këto të dhëna të futen në faturë, por nuk ka kontroll në atë rast.</li> </ul> <p>Gjithashtu, kjo fushë është e detyrueshme nëse blerësi lëshon faturën në vend të shitësit.</p> <p>Nëse është vendosur kjo fushë, përveç në librin e shitjeve të shitësit, kjo faturë do të paraqitet edhe në librin e blerjes së blerësit nëse blerësi është një tatimpagues.</p> <p>Nëse blerësi është një individ që kërkon faturë për njohjen e kostos së ilaçeve, nuk do të krijohet asnjë libër blerjeje për të, por do të krijohet një aplikim i veçantë për të regjistruar të gjitha të dhënat në të gjitha faturat, ku ai është shfaqur si blerës dhe ai informacion do të shkëmbehet me sistemin e Platformës Qendrore të Faturave.</p> <p>Gjithashtu, të dhënat mund të futen për një të huaj ose diplomat, i cili do të kërkojë një rimbursim të TVSH-së dhe këto informacione do të shkëmbehen edhe me sistemin e Platformës Qendrore të Faturave.</p>	<p>Fushë fakultative (E detyrueshme në transaksionet B2B dhe situatë tjetër e veçantë)</p>
<b>FUSHË 17.</b> <b>"Buyer.Name"</b>	<p><b>EMRI I BLERËSIT</b></p> <p>Emri i plotë i blerësit</p>	<p>Fusha e detyrueshme në rast se fusha 16 plotësohet ose në rastin e eksportit të mallrave, por gjithashtu mund të plotësohet nëse fusha 16 është bosh.</p>
<b>FUSHË 18.</b> <b>"Buyer.Address"</b>	<p><b>ADRESA E BLERËSIT</b></p> <p>Këtu vendoset adresa e blerësit.</p> <p>Në rast se është person juridik, adresa e selisë qendrore të personit juridik vendoset këtu dhe në rast se është person fizik, atëherë vihet adresa e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, ose për individët, adresa e banimit.</p>	<p>Fusha e detyrueshme në rast se fusha 16 plotësohet ose në rastin e eksportit të mallrave, por gjithashtu mund të plotësohet nëse fusha 16 është bosh.</p>
<b>FUSHË 19.</b> <b>"Buyer.Town"</b>	<p><b>QYTETI I BLERËSIT</b></p>	<p>Fusha e detyrueshme në rast se fusha 16 plotësohet ose në rastin e eksportit të mallrave, por gjithashtu mund të plotësohet nëse fusha 16 është bosh.</p>
<b>FUSHË 20.</b> <b>"Buyer.Country"</b>	<p><b>SHTETI I BLERËSIT</b></p>	<p>Fusha e detyrueshme në rast se fusha 16 plotësohet ose në rastin e eksportit të mallrave, por gjithashtu mund të plotësohet nëse fusha 16</p>

		është bosh.
FUSHË 21. "SameTaxes"	<p><b>SHUMA TOTALE E ÇDO FATURE PËR ÇDO NIVEL (NORMË) TË NJËJTË TVSH-JE</b></p> <p>Kjo fushë mund të ketë më shumë se një rresht rekordesh, pasi aktualisht ekziston më shumë se një normë e TVSH-së.</p> <p>Kjo fushë përfaqëson një kombinim të disa fushave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Numri i artikujve me të njëjtën normë të TVSH-së</li> <li>Baza e tatueshme</li> <li>Norma e tatimit</li> <li>Përrjashtim nga TVSH-ja</li> <li>Shuma e TVSH-së</li> </ol> <p><b>A. Numri i artikujve</b></p> <p>Llogarit numrin e përgjithshëm të artikujve në të njëjtën normë të TVSH-së dhe kjo shumë është e shkruar në këtë fushë.</p> <p><b>B. Baza e tatueshme</b></p> <p>Llogarit shumën totale të secilës bazë të tatueshme që do të tatohet me të njëjtën normë të TVSH-së; hyrje nga vlerat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>baza e tatueshme për aplikimin e normës 0%</li> <li>baza e tatueshme për aplikimin e normës 6%</li> <li>baza e tatueshme për aplikimin e normës 10%</li> <li>baza e tatueshme për aplikimin e normës 20%</li> <li>baza e tatueshme për aplikimin e përrjashtimit të TVSH-së</li> </ol> <p><b>C. Norma e TVSH</b></p> <p>Norma e TVSH e zbatueshme që duhet te vendoset (0 ose 6ose 10 ose 10 ose 20)</p> <p><b>D. Përrjashtimi nga TVSH</b></p> <p>Përrjashtim nga TVSH sipas Kapitullit VIII, Seksioni 1 I Ligjit të TVSH-së:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përrjashtohet në bazë të nenit 51 të ligjit të TVSh-së</li> <li>Përrjashtohet në bazë të neneve 53 dhe 54 të ligjit të TVSh-së</li> </ol> <p><b>E. Shuma e TVSH-së</b></p> <p>Fusha është numerike me dy shifra dhjetore. Në këtë fushë është vendosur shuma absolute e TVSH-së.</p>	Fushë e detyrueshme nëse lëshuesi i faturës është pagues i TVSH-së ose aplikon vetë-faturimin dhe shitësi është tatimpaguesi i TVSH ose është zbatuar "auto-ngarkesa".
FUSHË 22. "ConsTaxes"	<p><b>TATIMI I KONSUMIT- aktualisht jo i përdorur</b></p> <p>Kjo fushë përfaqëson një kombinim të disa fushave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Numri i artikujve në të njëjtën normë tatimore</li> <li>Baza e tatimit</li> <li>Norma e tatimit</li> <li>Shuma e tatimit</li> </ol> <p><b>A. Numri i artikujve</b></p> <p>Llogarit numrin e përgjithshëm të artikujve me të njëjtën normë dhe kjo shumë është e shkruar në këtë fushë.</p> <p><b>B. Baza e tatimit</b></p> <p>Llogarit shumën totale të secilës bazë individuale tatimore që do të tatohet me të njëjtën normë;</p> <p><b>C. Norma e tatimit</b></p> <p>Duhet të bëhet lista e tatimeve. Duhet të jetë e mundur për të modifikuar këtë listë ose tabelë me rregulla të veçanta aksesi.</p> <p>Normat e tatimeve (Lista e vlerës):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Norma 0% - 0.00</li> <li>Norma II - 6,00</li> </ol> <p><b>D. Shuma e tatimit</b></p> <p>Fusha është numerike me dy vende dhjetore. Në këtë fushë është futur shuma absolute e tatimit.</p>	Fushë fakultative
FUSHË 23. "TaxFreeAmt"	<p><b>SHUMA E SHITJES PA TVSH</b></p> <p>Shuma totale e mallrave dhe shërbimeve të dorëzuara kur TVSH-ja nuk është e ngarkuar (qoftë sepse tatimpaguesi nuk është tatimpagues ose ka një përrjashtim tjetër përveç atij të specifikuar në Fushë 21 nën C. pikën e.), as në fushën 24 ose 25. Shumat e lejuara me një shenjë negative.</p>	Fushë fakultative
FUSHË 24.	<b>SHUMA LIDHUR ME PROCEDURËN SPECIALE TË SKEMËS SË</b>	Fushë fakultative

<b>"MarkUpAmt"</b>	<b>MARZHIT</b> Shuma totale që i përket procedurës të skemës së veçantë të marzhit në faturë në formë dhjetore (shuma e tatueshme). Marzhi për mallrat e përdorura, veprat e artit, koleksionet ose antikuarët. Shumat e lejuara me një shenjë negative.	
<b>FUSHË 25.</b> <b>"GoodsExAmt"</b>	<b>EKSPORTI I MALLRAVE</b> <b>Pa TVSH në faturë.</b> Shuma totale e vlerës së mallrave për eksport jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të shkruhet në këtë fushë.	Fushë fakultative
<b>FUSHË 26.</b> <b>"Fees"</b>	<b>TARIFAT</b> Tarifat përcaktohen në këtë fushë. Mund të ketë shumë lloje të ndryshme tarifash në një faturë. Çdo tarifë përcaktohet nga dy fusha: <b>A. LLOJI I TARIFËS</b> - Fushë jo e detyrueshme. Etiketat vendosen nga lista e vlerave. <b>B. SHUMA E TARIFAVE</b> - Fushë e Detyrueshme nëse vendoset Fusha A. Shkruhet shuma dhjetore e tarifës në monedhën e vendit.	Fushë fakultative
